



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në
“Informatikë”
Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Miranda HARIZAJ

2. Dr. Evis TRANDAFILI

Shkurt/ 2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në “Informatikë”**

1	IAL aplikues:	Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Matematikës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Informatikë”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	MASH me shkresë nr. 2517/1, datë 19.07.2002
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 264, datë 28.05.2021
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite / 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit (për vitin akademik 2022-2023)	12/5 Bazuar në ngarkesën mësimore rezulton: 85 % PAE / 15 % PAK
18	Numri i studentëve (për një cikël të plotë studimi):	150 studentë
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Më 2 shtator 1957 u hap Instituti i Lartë Pedagogjik 2-vjeçar i Shkodrës me VKM Nr.150, datë 18.04.1957. Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës me VKM Nr. 124, datë 01. 04. 1989, do të emërtohet Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës "Luigj Gurakuqi". Universiteti "Luigj Gurakuqi" është riorganizuar me VKM Nr. 124, datë 28.05.1991 duke marrë statusin e Universitetit. Njësitë kryesore të institucionit janë:

1. Fakulteti i Shkencave të Natyrës
2. Fakulteti i Shkencave të Edukimit
3. Fakulteti i Shkencave Shoqërore
4. Fakulteti i Drejtësisë
5. Fakulteti Ekonomik
6. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

IAL ka zhvilluar procesin e fundit të vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik. Ky vlerësim u finalizua me VBA Nr. 3, datë 24.01.2020 që e akrediton institucionin për 4 vite akademike.

MASH me shkresë nr. 2517/1, datë 19.07.2002 ka miratuar hapjen e programit të studimit Bachelor në "Informatikë", pjesë e Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Ky program është riorganizuar për shkak të ndryshimeve në legjislacionin për Arsimin e Lartë. Aktualisht programi ka hyrë në procesin e akreditimit. Kohëzgjatja e tij normale është 3 vite dhe numri krediteve të tij është 180 ECTS.

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) është hartuar në vijim të detyrimeve për akreditimin e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Informatikë", ofruar nga Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër. Në hartimin e këtij Raporti, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) është mbështetur në dokumentacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit të përgatitur nga Grupi i Vetëvlerësimit për këtë program studimi, në konstatimet, gjetjet dhe shënimet e mbajtura gjatë takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në Institucion, si dhe në dokumentacionin shtesë të kërkuar dhe vënë në dispozicion nga Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;



Ky raport është përgatitur nga grupi i ekspertëve të jashtëm të përcaktuar nga ASCAL në përputhje me Manualin 2017 dhe. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Dr. Miranda Harizaj dhe Dr. Evis Trandafili. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Zj. Aviola Bardhi.

Ekspertët fillimisht vlerësuan dokumentacionin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër, në kuadër të procedurës së aplikimit për akreditim të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Informatikë", nga Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër, e përbërë nga 153 dokumenta në total. Ekspertët sipas një axhende të hartuar në funksion të procesit të vlerësimit të programit të studimit kanë realizuar vizitat në datë 12 - 13 Korrik 2023, në institucion sipas veprimtarive të parashikuara në axhendë, në funksion dhe plotësim të procesit të vlerësimit të jashtëm nga ekspertët. Grupi i ekspertëve ka vijuar punën për hartimin e një raporti të integruar të vlerësimit të jashtëm të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Informatikë", bazuar në gjetjet dhe konstatimet e zbatimit të kriterëve të standarteve shtetërore të cilësisë nga institucioni i arsimit të lartë Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër.

Më datë 25.01.2024, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 20/1 Prot., datë 25.01.2024, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.

Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër kthehu përgjigje në sistemin AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 77/3 Prot., datë 08.02.2024.

IAL nuk ka komente mbi draftin, kështu drafti kthehet në raport final.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Informatikë”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër, GVJ konstaton se në misionin e tij, IAL ka për qëllim të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë dhe të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe të shërbimeve, si dhe të nxisë e të zhvillojë artet, edukimin fizik dhe sportet. Pjesë e misionit të kësaj IAL është të përgatisë e formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj dhe dhe të mbështesë zhvillimin kulturor e social-ekonomik në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Në planin strategjik USH është e angazhuar në zhvillimin dhe rritjen e potencialit të shkencave natyrore në vend dhe të kontribuojë në zhvillimin e kapaciteteve shkencore dhe teknologjike të vendit. Evidencë 1. Statuti ush, neni 4; Evidencë 2.2 plani strategjik i fshn; Evidencë 3 - 9. Strategjitë sektoriale; Evidencë 2. Rregullore e studimeve në ush.
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Ky program studimi ofrohet në përputhje me misionin dhe qëllimet e institucionit dhe strategjinë për zhvillim të institucionit. Në zbatim të misionit, objektivave dhe drejtimeve akademike të tij, USH ka për qëllim zhvillimin e arsimit, kulturës, shkencës dhe ekonomisë, në shërbim të lirisë dhe diversitetit të ideve, si dhe të përgatisë specialistë që përmbushin kërkesat e tregut shqiptar dhe ndërkombëtar të punës.
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimeve akademike të tij.	Njësia kryesore ofron programe studimi në fushën e informatikës që prej vitit 2002. Gjithashtu për programin Bachelor në “Informatikë” objektivi kryesor është të përgatisë studentët me njohuritë e përgjithshme në fushën e informatikës dhe disiplinave të saj, duke ju mundësuar studentëve një formim bazë që ju ofron mundësi për studime më të thelluara në këtë fushë, si dhe që i përgatit studentët për tregun e punës në sektorin publik dhe privat, si në fushën e informatikës. Evidencë 1. Statuti ush, neni 4; Evidencë 2.2 plani strategjik i fshn; Evidencë 3 - 9. Strategjitë sektoriale; Evidencë 2. Rregullore e studimeve në ush; Evidencë 1.1 hapja e degës informatikë.
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një	GVJ konstaton, nga vlerësimi i dokumentacionit, vizitës në institucion dhe dokumentacionit shtesë të kërkuar, se USH ka një përvojë prej 2002 në fushën akademike të informatikës dhe disponon kapacitete si në infrastrukturë dhe burime të nevojshme për këtë program studimi. Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Matematikës. Fakulteti

programi studimi në atë fushë.	i Shkencave të Natyrës për vitin akademik 2022-2023 ka gjithsej 164 pedagogë, nga të cilët 48 janë PAE nga ku: 3 janë me gradën Prof.Dr, 8 janë me gradën Prof.Asoc.Dr., 20 me gradën Dr dhe 17 asistent lektorë me Master i Shkencave, nga të cilët 2 me gradën Dr. në process. Në FSHN 116 janë PAK, nga të cilët 2 me gradën Prof.Dr, 9 me gradën Dr. dhe 27 Asistent Lektorë - Master i Shkencave, si dhe 78 që nuk është saktësuar në raport, por supozohet të jenë Asistent Lektorë - Master i Shkencave. Ndërsa Departamenti i Matematikës përgjegjës për programin e studimit Bachelor në "Informatikë" ka 11 PAE dhe 24 PAK. Evidencë shtesë Tabela permbledhese aneks, Tabelat 1 dhe 2.			
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Njësia kryesore, Fakulteti i Shkencave të Natyrës ofron programe studimi në fushën e shkencave të natyrës që prej themelimit të tij në vitin 1957. Kjo njësi kryesore ofron gjithashtu 12 programe të tjera në fushën e shkencave të natyrës : 6 në Bachelor, 5 në Master Profesional dhe 1 në Master i shkencave. Në rregulloren e programit të studimit Bachelor në "Informatikë" është përcaktuar se ky program është projektuar dhe fokusuar në përgatitjen e formimin e një brezit me intelektualë dhe specialistë të mirë, në përputhje me një nga fushat akademike e kërkimore të njësisë bazë përgjegjëse për këtë program. Evidencë 1.6 Rregullore e FSHN; Evidencë 2.9 Rregullore studimesh Informatike; Evidencë shtesë Tabela permbledhese aneks, Tabela 3.			
Konkluzione	<p>- <i>USH në misionin e objektivat e tij ka për qëllim të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë dhe të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe të shërbimeve, si dhe të nxisë e të zhvillojë artet, edukimin fizik dhe sportet. Pjesë e misionit të kësaj IAL është të përgatisë e formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj dhe dhe të mbështesë zhvillimin kulturor e social-ekonomik në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar.</i></p> <p>-<i>Njësia kryesore ofron programe studimi në fushën e informatikës që prej vitit 2002 dhe disponon kapacitete në mbështetje të saj, në infrastrukturë dhe burime të nevojshme.</i></p> <p>- <i>Fusha e programit të studimit Bachelor në "Informatikë" është në përputhje me një nga fushat akademike e kërkimore të njësisë bazë.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se USH siguron bashkëpunimin dhe realizon ndarjen e detyrave mes njërive e personelit në rregulloret respektive, si dhe ndjekjen e zbatimit të tyre. Nga vlerësimi rezulton se Departamenti i Matematikës menaxhon dhe drejton me efektivitet programin e ciklit të parë, programi i studimit Bachelor në "Informatikë", i cili ka një kohëzgjatje 3-vjeçare dhe në total përmban 180 kredite. GVJ konstatoi që ndarja e detyrave, vendimmarrja dhe llogaridhënia janë të harmonizuara në aktet rregullatore të institucionit. Njësia bazë ka peshën kryesore për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.</p> <p>Evidencë 2. Rregullore e studimeve në ush; Evidencë 1.6 rregullore e fshn; Evidencë 2.9 rregullore studimesh informatike; Evidencë 40. Rregullore e administrates ush; Evidencë 11. Rregullore e punesimit; Evidencë 3.5 rregullore e njsbc, fshn.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>GVJ eidenton se USH ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi ndërinstucionale me institucione shtetërore dhe IAL, si dhe me kompani private brenda dhe jashtë vendit, në funksion dhe të këtij programi studimi.</p> <p>Evidencë 36. Marrëveshjet e bashkëpunimit në rang universitet; Evidencë 2.17 Marrëveshje kuadër - Mou University of Shkodra Luigj Gurakuqi; Evidencë 1.7 Marrëveshje praktika AL.</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga DVV dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në USH, GVJ konstaton se institucioni ka nënshkruar marrëveshje me institucione apo kompani të biznesit në funksion dhe të praktikave profesionale. Në të njëjtën kohë ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe shkëmbimi më IAL në vend dhe jashtë, si dhe në kuadër të projekteve ERASMUS +, exchange dhe mobilitet. <u>Aktualisht nuk ka projekte ERASMUS +, exchange dhe mobilitet aktive në këtë program studimi.</u></p> <p><u>GVJ rekomandon që USH të shtojë angazhimin dhe aplikimet për këto projekte pasi mbështesin përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie dhe në mësimnxënie në programin e studimit, si dhe realizimin e programit të studimit.</u></p> <p>Evidencë 36. Marrëveshjet e bashkëpunimit në rang universitet; Evidencë 2.17 marrëveshje kuadër - mou university of shkodra luigj gurakuqi; Evidencë 1.7 marrëveshje praktika al.</p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet</p>	<p>Nga IAL dhe FSHN, si pjesë e RVB dhe analizës vjetore të vetëvlerësimit realizohet dhe paraqitet një analizë të bashkëpunimit me aktorët e jashtëm dhe përfitimit në kuadër të procesit mësimor dhe formues.</p>

e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Evidencë 19. Rvb institucionale 2022; Evidencë 6.2 rvb fshn 2021-2022.			
Konkluzione	<ul style="list-style-type: none"> - <i>USH ka siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione publike dhe kompani private në vend dhe jashtë në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisit profesional dhe mobilitetit.</i> - <i>USH ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe shkëmbimi me IAL në vend dhe jashtë, si dhe në kuadër të projekteve ERASMUS +, exchange dhe mobilitet. Aktualisht nuk ka projekte ERASMUS +, exchange dhe mobilitet aktive në këtë program studimi.</i> - <i><u>GVJ rekomandon që USH të shtojë angazhimin dhe aplikimet për këto projekte pasi mbështesin përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie dhe në mësimnxënie në programin e studimit, si dhe realizimin e programit të studimit.</u></i> 			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>GVJ konstaton se struktura e programit të studimit Bachelor në “Informatikë” është organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi, dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program studimi ka një kohëzgjatje 3 vite dhe në total 180 kredite dhe përmban të shprehura shpërndarjen e krediteve midis lëndëve, një ndarje të qartë të lëndëve sipas kategorive të përcaktuara në VKM Nr. 185, datë 25.3.2021, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 41, datë 24.1.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, të ndryshuar, dhe secila prej tyre ka të përcaktuar ngarkesën përkatëse në kredite duke e respektuar totalin vjetor prej 60 kreditesh dhe <u>përgjithsisht përqindjen sipas secilit tip të komponentit mësimor, me një shmangje të vogël për lëndët ndërdisiplinore, nga maksimumi 15 % e lejuar është 15.6 % :</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Lëndët bazë 15.6%; • Lëndët karakterizuese 54.4%; • Lëndët ndërdisiplinore 15.6%; • Lëndët plotësuese 10%; • Detyrimet përmblylëse 4.4 %. <p>Si dhe plotësohet kriteri që përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B nuk duhet të jetë më pak se 70%.</p> <p><u>GVJ rekomandon të përcaktohen kreditet brenda % së lejuar për të gjithë komponentët mësimor.</u></p> <p>Evidencë 1.6 Rregullore e FSHN;</p> <p>Evidencë 2.9 Rregullore studimesh Informatike;</p> <p>Evidencë shtesë Tabela përmbledhese aneks, Tabela 9.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Informatikë” synon t’i përgatisë dhe formojë studentët me njohuritë dhe kompetencat e nevojshme teorike dhe praktike në fushën e informatikës si programimi, komunikimi, menaxhimi i bazave të të dhënave, zhvillimin e softwareve, zhvillimin e website-ve, mediat dixhitale etj. GVJ konstaton se ky objektivi përmbushet dhe rezulton e shprehur qartë në rregulloren e programit dhe në syllabuset e lëndëve.</p> <p>Evidencë 2.9 Rregullore studimesh Informatike;</p> <p>Evidencë 3.6 Programet e lëndëve;</p> <p>https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/2023/Planet_Mesimore/2023/Bachelor/FSHN/Fshn_Ba- Informatike__2023.PDF.</p>

komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Ky program studimi ka të grupuara qartë lëndët dhe modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe në raportin e kërkuar në VKM Nr. 185, datë 25.3.2021, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 41, datë 24.1.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, të ndryshuar. Plotësohet dhe kriteri që përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B nuk duhet të jetë më pak se 70%. Evidencë 2.9 Rregullore studimesh Informatike; Evidencë 3.6 Programet e lëndëve; Evidencë shtesë Tabela permbledhese aneks, Tabela 9; https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/2023/PlanetMesimore/2023/Bachelor/FSHN/Fshn-_Ba-_Informatike_2023.PDF
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi i studimit Bachelor në “Informatikë” në kurrikulën e tij parashikon zhvillimin e praktikës profesionale si veprimtari formuese dhe ka përcaktuar ngarkesën me 5 kredite. Gjithashtu për detyrimin përmbyllës ka përcaktuar ngarkesën me 8 kredite, që në përgjithësi është provim përfundimtar dhe në raste të veçanta, me kërkesë të studentit, si mbrojtje diplome bazuar në kriteret e miratuara rregulloren e programit të studimit (neni 36), për studentët me mesatare të rezultateve të studimeve më të lartë se 8.5. Evidencë 2.9 Rregullore studimesh Informatike; Evidencë shtesë Tabela permbledhese aneks, Tabela 9 dhe 10. https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/2023/Planet_Mesimore/2023/Bachelor/FSHN/Fshn-_Ba-_Informatike__2023.PDF .
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Nuk aplikohet në këtë program studimi.
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtëse, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në “Informatikë” ka një plan mësimor të ngjashëm me programet e studimit në fushë mbi masën 70 %. Hapja e këtij programi është mbështetur në programe të ngjashme të fushës në nivel kombëtar (universiteti i Tiranës). Evidencë 3.6 Programet e lëndëve; Evidencë 2.4 Bachelor Informatikë UT 2020-2023 Evidencë shtesë Tabela permbledhese aneks, Tabela 9; https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/2023/PlanetMesimore/2023/Bachelor/FSHN/Fshn-_Ba-_Informatike_2023.PDF




<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>GVJ konstaton USH është në proces kodifikimi të programit të studimit, në bazë të VKM nr. 310, datë 11.5.2022 "Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Kodi i propozuar për programin e studimit është 63BA0541S.</p> <p>Evidencë 2.5 Kodifikimi i programit Informatikë.</p>			
<p>Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Nuk aplikohet në këtë program studimi.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Ky program studimi është organizuar nga USH në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore. <u>GVJ rekomandon të përcaktohen kreditet brenda % së lejuar për të gjithë komponentët mësimor.</u> - Ky program studimi ka të përcaktuar në planin mësimor ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblylësesi dhe është i ngjashëm me programet e studimit në fushë mbi masën 70 %. - Ky program studimi është në proces kodifikimi i programit të studimit. 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Standardi II.2</p>	
<p>Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Institucioni ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 3, datë 24.01.2020 që e akrediton institucionin për 4 vite akademike. FSHN si njësi kryesore përgjegjëse për këtë program studimi, ka në përbërje:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamentin e Biologji-Kimisë; • Departamentin e Matematitës; • Departamentin e Fizikës; • Departamentin e Infermierisë; • Qendra e Studimit të Ujrave.
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse</p>	

për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.

Përveç programit të studimit Bachelor në "Informatikë", DM ofron studime dhe në 3 programe të tjera, 1 program Bachelor dhe 2 të ciklit të dytë MP. Përgjegjësitë e njësisë kryesore dhe asaj bazë që janë përgjegjëse për programin e studimit, janë të përcaktuara në statutin, rregulloren e programeve të studimeve në USH, rregulloren e FSHN si dhe rregulloren specifike të programit të studimit. Dekani i fakultetit mban titullin akademik "Prof.As" ndërsa përgjegjësi i departamentit ka gradën shkencore, "Doktor i Shkencave".

FSHN në vitin akademik 2022-2023, ka në përbërje të tij 161 pedagogë gjithsej, ndër të cilët, 51 janë personel akademik efektiv (PAE), dhe 110 personel akademik me kontratë (PAK).

Stafi akademik sipas departamenteve për vitin akademik 2022-2023:

1. Departamenti i Matematikës:

- 14 PAE, ndër të cilët 4 me tituj / grada;
- 18 PAK, ndër të cilët 3 me tituj / grada.

2. Departamenti i Kimi-Biologjisë:

- 10 PAE, të gjithë me tituj / grada;
- 14 PAK, ndër të cilët 6 me tituj / grada.

3. Departamenti i Fizikës:

- 7 PAE, ndër të cilët 5 me tituj / grada;
- 0 PAK.

4. Departamenti i Infermierisë:

- 14 PAE, ndër të cilët ~~6~~ 7 me tituj / grada;
- 78 PAK, IAL nuk ka paraqitur informacion për tituj/grada

5. Qendra e Studimit të Ujrave:

- 6 PAE, të gjithë me tituj / grada;
- 0 PAK.

Ndërsa stafi akademik i Departamentit të Matematikës dhe Njësisë kryesore FSHN, që janë përgjegjës për programin e studimit, në vitin akademik 2022-2023 është: 14 personel akademik efektiv (PAE), nga të cilët 4 me grada shkencore dhe 18 staf akademik me kontratë (PAK), nga të cilët 3 me gradë shkencore.

Raporti PAE/PAK i anagazhuar në këtë program studimi është:

Viti akademik	Raporti PAE/PAK
2022-2023	12/5
2021-2022	9/5
2020-2021	9/8

Nga verifikimi i personelit akademik të përfshirë në mësimdhënie, konstatohet një qëndrueshmëri në stafin akademik.

Për sa më sipër GVJ konstaton se njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore minimale për numrin dhe kualifikimin grada/tituj të personelit akademik sipas përcaktimeve të parashikuara në Ligjin 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimit Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë të Republikës së Shqipërisë", neni 59, pika 6 ku citohet: "Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës".


	<p>Ngarkesa mësimore e personelit akademik për vitet akademike 2020-2023 është dhe mbulohet në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Për vitin akademik 2022-2023 ngarkesa mësimore e realizuar është përballuar në masën afro 85% nga personeli akademik efektiv (PAE) dhe afro 15% nga personeli akademik me kontratë (PAK), duke qenë në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV dhe vizita në IAL, GVJ konstaton se njësia kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, në plotësim të detyrimeve të përcaktuara ligjore ka të angazhuar për programin e studimit, 1 personel ndihmës akademik për realizimin e laboratorëve dhe praktikave mësimore me kualifikimin Msc.</p> <p>Evidencë 1. STATUTI USH; Evidencë 1.6 Rregullore e FSHN; Evidencë 2.9 Rregullore studimesh Informatike; Evidencë 3.6 Programet e lëndëve; Evidence 4.5 Kontratat pedagogë të brendshëm Evidencë shtesë Tabela përmbledhese aneks, Tabelat 1 dhe 2.</p>								
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV dhe vizita në IAL, GVJ konstaton se njësia kryesore, Departamenti i Matematikës përgjegjës për programin e studimit Bachelor në “Informatikë” ka caktuar koordinatorët e programit të studimit dhe të praktikës mësimore, që ndjek ecurinë e studentëve të këtij programi studimi, që në bashkëpunim me DM dhe zëvendësdekanin ndjek dhe merr masat e nevojshme në funksion të mbarëvajtjes së programit të studimit.</p> <p><u>GVJ rekomandon që roli dhe përgjegjësitë e koordinatorit të programit të studimit të përcaktohen në rregulloren e IAL.</u></p> <p>Evidencë 2.8 Vendim për koordinatorët e programit dhe praktikën mësimor.</p>								
<p>Konkluzione</p>	<ul style="list-style-type: none"> - GVJ evidenton se kriteret minimale të këtij standarti përmbushen për njësinë kryesore dhe bazë përgjegjëse për numrin dhe shkallën e kualifikimit(titujt) të personelit akademik që mbulon programin e studimit. - Ngarkesa mësimore realizohet në masën dërmuese nga personeli akademik efektiv duke respektuar detyrimet ligjore e nënligjore në fuqi. - Njësia bazë, Departamenti i Matematikës ka caktuar koordinatorin për programin e studimit. <u>GVJ rekomandon që roli dhe përgjegjësitë e koordinatorit të programit të studimit të përcaktohen në rregulloren e IAL.</u> 								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="587 1666 767 1756">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="767 1666 967 1756">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="967 1666 1166 1756">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1166 1666 1394 1756">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="587 1756 767 1807"></td> <td data-bbox="767 1756 967 1807"></td> <td data-bbox="967 1756 1166 1807"></td> <td data-bbox="1166 1756 1394 1807">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						




Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																														
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se Departamenti i Matematikës, si njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e Programit të studimit Bachelor në “Informatikë”, disponon të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Ky informacion publikohet dhe në faqen kryesore të USH. Departamenti i Matematikës, disponon informacionet dhe ka vënë në dispozicion dokumentacionin për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit si: rregulloren e programit të studimit, planin mësimor, syllabuset e lëndëve, stafin akademik të programit etj.</p> <p>Evidencë 1.6 Rregullore e FSHN; Evidencë 2.9 Rregullore studimesh Informatike; Evidencë 3.6 Programet e lëndëve; Evidencë shtesë Tabela permbledhese aneks. https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/2023/Planet Mesimore/2023/Bachelor/FSHN/Fshn_Ba_Informatike_2023.PDF.</p>																														
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>GVJ konstaton se veprimtaritë formuese të programit të studimit janë shpërndarë në përputhje me VKM Nr. 185, datë 25.3.2021, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 41, datë 24.1.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, të ndryshuar, si në tabelën më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="619 1144 1378 1783"> <thead> <tr> <th>Kategoria</th> <th>Përshkrimi</th> <th>% sipas VKM 41</th> <th>Kredite/ ECTS</th> <th>%</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A</td> <td>Lëndë bazë</td> <td>15-20</td> <td>28</td> <td>15.6</td> </tr> <tr> <td>B</td> <td>Lëndë karakterizuese</td> <td>50 - 55</td> <td>98</td> <td>54.4</td> </tr> <tr> <td>C</td> <td>Lëndë ndërdisiplinore/ integruese</td> <td>12 -15</td> <td>28</td> <td>15.6</td> </tr> <tr> <td>D</td> <td>Lëndë plotësuese (praktika profesionale)</td> <td>10 -15</td> <td>18</td> <td>10</td> </tr> <tr> <td>E</td> <td>Detyrime përmbyllëse (provim përfundimtar/ punimi diplome)</td> <td>3 - 5</td> <td>8</td> <td>4.4</td> </tr> </tbody> </table> <p>Nga shqyrtimi i rregullores së programit, planit mësimor dhe syllabuseve të programit të studimit, GVJ konstaton se ky program studimi përmban 23 lëndë, nga të cilat 5 janë lëndë vjetore (në 2 semestra) dhe 2 lëndë me zgjedhje dhe provimin përfundimtar/ punimin</p>	Kategoria	Përshkrimi	% sipas VKM 41	Kredite/ ECTS	%	A	Lëndë bazë	15-20	28	15.6	B	Lëndë karakterizuese	50 - 55	98	54.4	C	Lëndë ndërdisiplinore/ integruese	12 -15	28	15.6	D	Lëndë plotësuese (praktika profesionale)	10 -15	18	10	E	Detyrime përmbyllëse (provim përfundimtar/ punimi diplome)	3 - 5	8	4.4
Kategoria	Përshkrimi	% sipas VKM 41	Kredite/ ECTS	%																											
A	Lëndë bazë	15-20	28	15.6																											
B	Lëndë karakterizuese	50 - 55	98	54.4																											
C	Lëndë ndërdisiplinore/ integruese	12 -15	28	15.6																											
D	Lëndë plotësuese (praktika profesionale)	10 -15	18	10																											
E	Detyrime përmbyllëse (provim përfundimtar/ punimi diplome)	3 - 5	8	4.4																											




	<p>e diplomës. Në çdo semester I - V janë 5 lëndë dhe në semestrin e VI-të janë 4 lëndë dhe provimi perfundimtar/punimi i diplomës.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Informatikë” përmban në planin mësimor informacionin e nevojshëm për:</p> <ol style="list-style-type: none"> Grupin e lëndëve që studenti kryen çdo semester dhe çdo vit akademik; Numrin total të krediteve që fiton studenti si dhe numrin e krediteve për secilën lëndë, si dhe orët në total për çdo lëndë në auditor/ jashtë auditorit. ngarkesën mësimore(orët në auditor/ jashtë auditorit) të secilës lëndë, sipas veprimtarive mësimore: leksion, seminar, laborator, detyre kursi etj. <p>Evidencë 2.9 Rregullore studimesh Informatike; Evidencë 3.6 Programet e lëndëve; Evidencë shtesë Tabela përmbledhese aneks. https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/2023/Planet_Mesimore/2023/Bachelor/FSHN/Fshn_Ba_Informatike_2023.PDF.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se rregulloret e USH, FSHN dhe të programit të studimit Bachelor në “Informatikë” përmbajnë përgjithsisht informacionet e nevojshme që lidhen me pranimin, regjistrimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve. GVJ citon nga rregullorja e programit: “Kriteret e pranimit të studentëve propozohen nga Departamenti i Matematikës dhe miratohen nga Senati Akademik brenda periudhës së përcaktuar nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe dërgohen në institucionet e MAS, QSHA dhe RASH. Kriteret publikohen dhe janë të aksesueshme në portalin U-Albania dhe në faqen zyrtare të USH.</p> <p>Evidencë 2. RREGULLORE E STUDIMEVE NË USH; Evidencë 1.6 Rregullore e FSHN; Evidencë 2.9 Rregullore studimesh Informatike.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se në rregulloren e programit të studimit, si dhe në syllabuset e lëndëve, paraqitet informacion i hollësishëm mbi detyrimin e frekuentimit / ndjekjes së programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve, etj. Syllabuset e lëndëve janë hartuar sipas formatit të miratuar sipas VKM Nr. 185, datë 25.3.2021, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 41, datë 24.1.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, të ndryshuar dhe informojnë në lidhje me detyrimin për frekuentimin/ ndjekjen e programit nga studenti, mënyrën e vlerësimit të dijeve, literaturën, sasia e orëve mësimore në total për çdo tematikë të lëndës, pedagogun e lëndës etj, <u>por nuk jepen orët mësimore sipas formatit: kreditet, orët në auditor dhe studimi individual për secilin element të lëndës.</u></p> <p><u>GVJ evidenton se në disa syllabuse të lëndëve të programit të studimit, titullari i lëndës mungon ose nuk ka gradë shkencore Doktor ose titull akademik sipas kriterit Prof. ose Prof.As. Gjithashtu në syllabuset e lëndëve nuk janë të përcaktuara temat e detyrave/ projekteve të kursit dhe të punëve laboratorike, si dhe formati i citimit të literaturës duhet të</u></p>


	<p><u>përmbajë autorin/autorët, titullin e botimit, shtëpinë botuese dhe vitin e botimit.</u></p> <p>Evidencë 2.9 Rregullore studimesh Informatike; Evidencë 3.6 Programet e lëndëve; Evidencë shtesë Tabela permbledhese aneks, Tabela 14.</p>			
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se në IAL janë të përcaktuara procedurat që ndiqen për përmirësimet dhe ndryshimet në përmbajtjen e programit të studimit, në fillim të cdo viti akademik. Bazuar dhe në rregulloren e studimeve USH, riorganizimi i programit të studimit bachelor në “Informatikë” (kurrikulës) propozohet nga Departamenti i Njësisë bazë dhe i përcillet për miratim Dekanatit të Njësisë Përgjegjëse të programit të studimit. Dekanati pasi e shqyrton në detaje dhe bashkë me korrigjimet e mundshme, ja përcjell propozimin për miratim Senatit Akademik të USH. Përditësimi i programeve të lëndëve që janë pjesë e programit të studimit bachelor në “Informatikë” propozohet nga personeli akademik i lëndës dhe miratohet nga përgjegjësi i njësisë bazë që e ofron atë lëndë. GVJ evidentoi në DVV, se ndryshime të vogla në planin mësimor brenda limitit të lejuar nga IAL janë miratuar në Korrik 2022 nga DA dhe janë efektive për vitin akademik 2023-2024.</p> <p>Evidencë 2.9 Rregullore studimesh Informatike; Evidencë 3.6 Programet e lëndëve; Evidencë 2.12 Ndryshime në planin mësimor; Evidencë shtesë Tabela permbledhese aneks, Tabelat 9,10,11 dhe 14.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<ul style="list-style-type: none"> - <u>Njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Bachelor në “Informatikë” disponon të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</u> - <u>Ky informacion publikohet dhe në faqen kryesore të USH duke përfshirë planin e studimit, në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.</u> - <u>Në syllabuset e lëndëve nuk paraqitet qartë ndarja e elementëve të lëndës (leksion, seminar, laborator, detyrë apo projekt kursi) në kredite, orë në auditor dhe studim individual për secilin element të lëndës, si dhe nuk përcaktohen temat e detyrave/projekteve të kursit dhe të punëve laboratorike, si dhe formati i citimit të literaturës duhet të përmbajë autorin/autorët, titullin e botimit, shtëpinë botuese dhe vitin e botimit.</u> - <u>GVJ rekomandon që titullarët në të gjithë lëndët e programit të studimit të caktohen sipas kritereve ligjore për titujt akademik.</u> - <u>GVJ rekomandon të plotësohen syllabuset e lëndëve me elementët e munguar.</u> 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi II.4																			
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimet të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.																			
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																		
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ ose punësimin e studentëve.	GVJ konstaton se shpërndarja e lëndëve dhe përmbajtja e veprimtarive të paraqitura në planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve (<i>ku mungojnë temat e detyrave/ projekteve të kursit dhe të punëve laboratorike</i>) mundësojnë përgatitjen e studentëve me aftësi dhe dijet e nevojshme teorike dhe praktike për studime të mëtejshme apo punësim në tregun e punës vendas dhe jashtë. Në kurrikulën e programit të studimit Bachelor në “Informatikë” është parashikuar zhvillimi i praktikës profesionale si lëndë apo veprimtari formuese. Evidencë 3.6 Programet e lëndëve; Evidencë shtesë Tabela përmbledhese aneks, Tabelat 9, 10, 11 dhe 14.																		
Kriteri 2. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se disa lëndë të rëndësishme për realizimin e objektivave dhe rezultateve të programit të studimit, në fushën e e programit të studimit janë: “Strukturë të dhënash I dhe II”, “Inxhinieri software”, “Programim Java I dhe II”, “Programim në Python”, “Elektronikë dhe Arkitekturë Kompjuteri”, “Programim Web” dhe “Gjuhë formale”. Shpërndarja e ngarkesës mësimore në të 6 semestrat e realizimit të programit është e balancuar për çdo semestër. Ngarkesa mësimore javore në auditor është:																		
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	<table border="0"> <tr> <td>1. Semestri I</td> <td>15 javë</td> <td>23 orë;</td> </tr> <tr> <td>2. Semestri II</td> <td>15 javë</td> <td>20 orë;</td> </tr> <tr> <td>3. Semestri III</td> <td>15 javë</td> <td>24 orë;</td> </tr> <tr> <td>4. Semestri IV</td> <td>15 javë</td> <td>21 orë;</td> </tr> <tr> <td>5. Semestri V</td> <td>15 javë</td> <td>23 orë;</td> </tr> <tr> <td>6. Semestri VI</td> <td>15 javë</td> <td>18 orë;</td> </tr> </table> <p>Struktura, lëndët dhe raporti teori-praktikë janë në përputhje me profilin e programit të studimit. Raporti teori/ praktikë në auditor është 57% me 36 %. Ky program studimi është i përafërt me programe të ngjashme kombëtare (UT). Evidencë shtesë Tabela përmbledhese aneks, Tabelat 9, 10, 11 dhe 13.</p>	1. Semestri I	15 javë	23 orë;	2. Semestri II	15 javë	20 orë;	3. Semestri III	15 javë	24 orë;	4. Semestri IV	15 javë	21 orë;	5. Semestri V	15 javë	23 orë;	6. Semestri VI	15 javë	18 orë;
1. Semestri I	15 javë	23 orë;																	
2. Semestri II	15 javë	20 orë;																	
3. Semestri III	15 javë	24 orë;																	
4. Semestri IV	15 javë	21 orë;																	
5. Semestri V	15 javë	23 orë;																	
6. Semestri VI	15 javë	18 orë;																	
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Në këtë program studimi gjatë 3 viteve akademike zhvillohen 1990 orë mësimore në auditor përkatësisht 766 orë leksion, 788 orë seminare, 355 orë ushtrime/ laboratore, 56 orë praktikë mësimore dhe 2510 orë mësimore studim individual, të specifikuara për çdo veprimtari mësimore. Gjatë takimeve me personelin akademik dhe me studentët e programit të studimit, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit evidentohet se raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve dhe mobilitet gjatë studimit, si dhe aftësimin e tyre për tregun e punës në fushën e informatikës.																		

	<p>Për vitet akademike 2020-2023, në këtë program studimi nuk ka pasur transferime por disa studentë kanë përfituar nga mobiliteti i projekteve Erasmus+ (Universiteti i Bolonjës dhe Sienës).</p> <p>Evidencë shtesë Tabela permbledhese aneks, Tabelat 9,10,11 dhe 13 dhe 14;</p> <p>Evidencë Takimet me Zyrën e projekteve;</p> <p>Evidencë shtesë Procedure per njohjen e Ekuivalentimit Erasmus.</p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se në IAL janë të mirëpërcaktuara procedurat që ndiqen për përmirësimet dhe ndryshimet në planin mësimor të programit të studimit dhe syllabuset e programit të studimit. Përditësimi i programeve të lëndëve që janë pjesë e programit të studimit Bachelor në “Informatikë” propozohet nga personeli akademik i lëndës dhe miratohet nga përgjegjësi i njësisë bazë që e ofron atë lëndë. Bazuar dhe në rregulloren e studimeve USH, riorganizimi i programit të studimit bachelor në “Informatikë” (kurrikulës) propozohet nga Departamenti i Njësisë bazë dhe i përcillet për miratim Dekanatit të Njësisë Përgjegjëse të programit të studimit. Dekanati pasi e shqyrton në detaje dhe bashkë me korrigjimet e mundshme, ja përcjell propozimin për miratim Senatit Akademik të USH. Përditësimi i programeve të lëndëve që janë pjesë e programit të studimit bachelor në “Informatikë” propozohet nga personeli akademik i lëndës dhe miratohet nga përgjegjësi i njësisë bazë që e ofron atë lëndë. GVJ evidentoi në DVV, se ndryshime të vogla në planin mësimor brenda limitit të lejuar nga IAL janë miratuar në Korrik 2022 nga DA dhe janë efektive për vitin akademik 2023-2024.</p> <p><u>Nga vlerësimi i literaturës së lëndëve, në syllabuse, konstatohet që për një pjesë të tyre, nuk është përcaktuar viti i botimit të literaturës dhe nuk është e 5 viteve të fundit sipas kriterit përkatës.</u></p> <p>Evidencë 2.9 Rregullore studimesh Informatike;</p> <p>Evidencë 3.6 Programet e lëndëve;</p> <p>Evidencë 2.12 Ndryshime në planin mësimor;</p> <p>Evidencë shtesë Tabela permbledhese aneks, Tabelat 9,10,11 dhe 14.</p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit siguron përfitim të njohurive, aftësive, si dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë. Studentë të programit të studimit kanë përfituar mobilitet në kuadër të projekteve Erasmus +.</p> <p>Evidencë 2.9 Rregullore studimesh Informatike;</p> <p>Evidencë 3.6 Programet e lëndëve;</p> <p>Evidencë Takimet me Zyrën e projekteve;</p> <p>Evidencë shtesë Procedure per njohjen e Ekuivalentimit Erasmus.</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit jep mundësi të mëtejshme studimi dhe punësimi të studentëve në përputhje me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Evidencë 3.6 Programet e lëndëve;</p> <p>Evidence 1.2 Fletëpalosja për Panairin Work & Study.</p>

Konkluzione	<p>- <i>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, përputhje me nivelin 6 të KSHK-së, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës në fushën e programit të studimit.</i></p> <p>- <i>Në këtë program studimi ka pasur ndryshime në vitin 2022, në planin mësimor të programit të studimit të miratuara nga USH dhe që janë bërë efektive në vitin akademik 2023-2024.</i></p> <p>- <i><u>Nga vlerësimi i literaturës së lëndëve, në syllabuse, konstatohet që për një pjesë të tyre, nuk është përcaktuar viti i botimit dhe për disa të tjera nuk është e 5 viteve të fundit sipas kriterit përkatës. GVJ rekomandon që të azhurnohet literatura në syllabuset e lëndëve, pasi duhet të jetë edhe të pasurohet edhe me botime të 5 viteve të fundit.</u></i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5 Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>USH ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të tregut të punës, në vend dhe jashtë vendit. Edhe në analizën vjetore, institucioni vlerëson edhe nevojat e tregut të punës, të evidentuara nga pyetësorët, takimet e drejtëpërdrejta por edhe nga bashkëpunimet institucionale si me partnerët e biznesit ashtu edhe me ata akademik. <i>GVJ konstatoi që nga Departamenti i Matematikës është kryer një studim tregu para disa vitesh, por që nuk është shumë i plotë dhe nuk përfshin kërkesat aktuale të tregut të punës.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon që Departamenti i Matematikës duhet të kryejë një studim të ri në tregun e punës të fushës së programit të studimit për të përmirësuar më tej këtë program studimi dhe për t'u përshtatur kërkesave dhe nevojave të tregut kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Në USH, studentët janë të përfaqësuar në organet kolegjiale sipas statutit dhe rregullores së studimeve në USH. Në kuadër të përmirësimit të programit, IAL nxit dhe përfshin në diskutime dhe studentët nëpërmjet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Anketimit për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit nga studentët e regjistruar që realizohet cdo semestër para provimeve; 2. Përfshirjen në strukturat e monitorimit dhe sigurimit të cilësisë. <p>Evidencë 1.2 Fletëpalosja për Panairin Work & Study; Evidencë 1.7 Marrëveshje praktika IAL: Evidencë 2.17 Marrëveshje kuadër - Mou University of Shkodra Luigi Gurakuqi;</p>

<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Evidencë 2.15 Studimi i Tregut të Punës Informatikë; Evidencë 3.5 Rregullore e NJSBC, FSHN; Evidencë 5.2 Enrat e studentëve përbërës në këshillin studentor; Evidencë 5.3 Analizë e pyetësorëve të studentëve; Evidencë 6.4 Formular për vlerësimin e pedagogut.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<ul style="list-style-type: none"> - <i>GVJ evidenton se në IAL, njësitë përgjegjëse janë angazhuar në përfshirjen e studentëve dhe bashkëpunëtorëve në përmirësimin e programit të studimit.</i> - <i>GVJ rekomandon që DM duhet të kryejë një studim të ri në tregun e punës të fushës së programit të studimit për të përmirësuar më tej këtë program studimi dhe për t'iu përshtatur kërkesave dhe nevojave të tregut kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</i> 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	




III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në USH, GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit Bachelor në “Informatikë” zhvillon forma të mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive përmes leksioneve, seminareve, punëve laboratorike, detyrave të kursit, praktikave profesionale të miratuara nga IAL bazuar në rregulloret e IAL dhe FSHN. Personeli akademik është mbështetur nga IAL në rritjen akademike dhe profesionale dhe është udhëzuar mbi metodat e reja të mësimdhënies innovative.</p> <p>Evidencë 2. Rregullore e studimeve në USH; Evidencë 1.6 Rregullore e FSHN.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Evidencë shtesë Praktike per Mbeshtetje Financiare per Kerkimin Shkencor. Evidence 3.13-Orë e hapur AlbaNSI Evidencë 29. Vendimi për financimin e botimeve dhe konferencave shkencore të stafit akademik të USH; Evidencë 30. Financimi i botimeve - Rregullore; Evidencë shtesë Praktike per Mbeshtetje Financiare per Kerkimin Shkencor. Evidencë 36. Marreveshjet e bashkëpunimit në rang universiteti.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>GVJ konstaton se USH angazhohet në mbështetjen e personelit akademik për përmirësimin e kompetencave të tyre didaktike. IAL ka inkurajuar dhe mbështetur stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien nëpërmjet trajnimeve dhe leksione të hapura për rritjen e kapaciteteve të tyre, të zhvilluara dhe në kuadër të programeve exchange të projekteve Erasmus+. Një pjesë e personelit akademik të angazhuar me kohë të plotë është me një ekperiencë shumëvjeçare në mësimdhënie. GVJ pas vizitës në institucion konstaton se mjediset ku zhvillohet mësimi i programit i mundësojnë personelit akademik përdorimin e metodave të shumëllojshme të mësimdhënies. Procesi i kompetencës së mësimdhënies mbështetet në këto etapa:</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të</p>	<p>1. Stafi akademik që aplikon për t'u angazhuar në mësimdhënie rekrutohet nëpërmjet një proces vlerësimi në bazë të kriterëve dhe dokumentacionit përkatës të ekspertizës dhe përvojës së aplikantit në fushë. 2. Në kuadër të përmirësimit të mësimdhënies dhe të nxënit USH inkurajon, mbështet rritjen profesionale të stafit akademik.</p> <p>Duke iu referuar CV-ve të personelit akademik, GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit Bachelor në “Informatikë” posedon përgatitjen dhe kompetencat e nevojshme profesionale.</p> <p>Evidencë 4.1 CV e stafit akademik; Evidence 3.13-Orë e hapur AlbaNSI</p>

<p>respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Evidencë shtesë Praktike per Mbeshtetje Financiare per Kerkimin Shkencor. Evidencë 29. Vendimi për financimin e botimeve dhe konferencave shkencore të stafit akademik të USH; Evidencë 30. Financimi i botimeve - Rregullore; Evidencë 36. Marreveshjet e bashkëpunimit në rang universiteti; Evidencë 4.3 Shembull hartimi kriteresh për PAE në Informatikë; Evidencë shtesë Procedure Rekrutimi Stafit; Evidencë 6.6 Pjesëmarrja e stafit në projekte.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Rezultatet e anketimeve dhe vlerësimeve periodike të anketës vlerësuese të studentit për stafin akademik, ku përfshihen dhe format dhe metodat e mësimdhënies, i komunikohen çdo pedagogu. USH ka zhvilluar mekanizma për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë, që janë rregulluar me rregulloret përkatëse zyrat për monitorimin e brendshëm të cilësisë dhe raportimi përkatës pranë njësive kryesore dhe bazë. Në kuadër të përmirësimit të programit, IAL nxit dhe përfshin në diskutime dhe studentët nëpërmjet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Anketimit për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit nga studentët e regjistruar që realizohet çdo semestër para provimeve; 2. Përshirjen në strukturat e monitorimit dhe sigurimit të cilësisë. <p>Evidencë 5.7 Analizë mësimore shkencore; Evidencë 17. Analiza mesimore- shkencore 2022; Evidencë 36. Marreveshjet e bashkëpunimit në rang universiteti. Evidencë 5.3-Analizë e pyetësorëve të studentëve; Evidencë 6.4-Formular për vlerësimin e pedagogut. Evidencë 3.5 Rregullore e NJSBC, FSHN; Evidencë shtesë. Tabela pëmbledhese aneks, Tabela 24.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Në nivel institucioni puna për vlerësimin e aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik drejtohet nga NJSBC. Kjo njësi ka rregulloren e saj, ku përcaktohet edhe mënyra e organizimit dhe detyrat që kanë njësitë kryesore dhe bazë. GVJ konstatoi se garantimi i përfshirjes së studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve mundësohet nëpërmjet pyetësorit të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies në programin e studimit, i cili plotësohet nga studentët në fund të çdo semestri para provimeve. Ky pyetësor është anonim dhe gjithë procesi drejtohet dhe monitorohet nga NJSBC. Rezultatet e pyetësorit, të paraqitura të pëmbledhura në raport dhe që i komunikohen personelit akademik, shërbejnë si bazë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Kjo anketë mundëson gjithashtu rritjen e vetëdijes së personelit akademik dhe studentëve për cilësinë në mësimdhënie. Nga takimet në institucion, GVJ u informua se personeli akademik ka në fokusin e tij përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Në mënyrë të veçantë në këtë drejtim kanë kontribuar mobilitetet e personelit akademik në universitete jashtë vendit. <i>Aktualisht në këtë program studimi nuk ka projekte aktive.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon që USH të shtojë angazhimin dhe aplikimet për projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat mbështetin</i></p>

	<p><u>përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie dhe në mësimnxënie në programin e studimit.</u></p> <p>Evidencë 5.7 Analizë mësimore shkencore; Evidencë 17. Analiza mesimore- shkencore 2022; Evidencë 6.6-Pjesëmarrja e stafit në projekte; Evidencë 5.3-Analizë e pyetësorëve të studentëve; Evidencë 6.4-Formular për vlerësimin e pedagogut. Evidencë 3.5 Rregullore e NJSBC, FSHN; Evidencë shtesë. Tabela përmbledhese aneks, Tabela 24.</p>			
Konkluzione	<ul style="list-style-type: none"> - <i>GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit Bachelor në "Informatikë" zhvillon format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive të miratuara nga IAL nëpërmjet rregulloreve specifike.</i> - <i>USH angazhohet në mbështetjen e personelit akademik për përmirësimin e kompetencave të tyre didaktike. DM vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë dhe reflektuar mendimin e studentëve.</i> - <i><u>Aktualisht në këtë program studimi nuk ka projekte aktive. GVJ rekomandon që USH të shtojë angazhimin dhe aplikimet për projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat mbështetin përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie dhe në mësimnxënie në programin e studimit.</u></i> - <i>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në USH organizon, drejton dhe monitoron përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies në nivel institucional.</i> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në rregulloren e studimeve në USH, Kreu IV "Kontrolli i dijeve" dhe në rregulloret e FSHN dhe programit të studimit. Mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive janë pjesë edhe e syllabuseve të cilat u bëhen të njohura studentëve javën e parë të çdo semestri akademik. Vlerësimi i kontrollit të dijes bëhet me notë, ku 5 është nota kaluese dhe 10 është vlerësimi më i lartë. Në format e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit kthehet në notë. Vlerësimi i studentit bëhet në dy pjesë: vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuara në programin e disiplinës/modulit dhe vlerësimi në provim. Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për lëndët/modulet e cilësuar provim në planin mësimor përfaqëson 20-</p>

	<p>40% të vleresimit përfundimtar. Përcaktimi i raporteve në mes të vleresimit të vazhduar gjatë vitit dhe vleresimit përfundimtar bëhet nga çdo pedagog dhe paraqitet për miratim pranë Departamentit të Matematikës në fillim të vitit akademik.</p> <p>Evidencë 2. Rregullore e studimeve në USH; Evidencë 1.6 Rregullore e FSHN; Evidencë 2.9-Rregullore studimesh Informatike; Evidencë 3.6 Programet e lëndëve; Evidencë shtesë. Tabela permbledhese aneks, Tabela 15.</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vleresimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Nga takimi me studentët dhe me stafin akademik, GVJ konstaton se Departamenti i Matematikës për programet që mbulon, informon studentët mbi metodologjinë e testimit dhe vleresimit të njohurive dhe dijeve.</p> <p>Format e kontrollit të dijeve janë të ndryshme, bazuar në specifikat e secilës lëndë. Forma të cilat janë të përcaktuara në plan-programin e lëndës dhe u bëhen të ditur studentëve në javën e parë të procesit mësimor. Studentët informohen rregullisht edhe mbi planet mësimore dhe kurrikulën e programit të studimit, këtu një rol të rëndësishëm luan edhe koordinatori i programit të studimit. Këtë informacion përveç informimit nga pedagogu i lëndës, studentët e gjejnë edhe në syllabuset e lëndëve. Informacioni mbi përmbajtjen e planit mësimor dhe kurrikulës së programit të studimit disponohet nga njësia bazë, publikohet në faqen zyrtare USH.</p> <p>Evidencë 3.6 Programet e lëndëve; Evidencë shtesë. Tabela permbledhese aneks, Tabela 15; https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/2023/Planet_Mesimore/2023/Bachelor/FSHN/Fshn-_Ba-_Informatike__2023.PDF.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>GVJ konstaton se testimi e vlerësimi i njohurive realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme. Format kryesore të kontrollit specifike për vlerësimin e nivelit të dijeve për këtë program studimi gjatë zhvillimit të një lënde janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive 10 % të notës përfundimtare; 2. Plotësimi i detyrimeve laborator apo detyrë kursi 10 % të notës përfundimtare; 3. Testimet gjatë vitit 20 % të notës përfundimtare; 4. Provimi përfundimtar 60 % të notës përfundimtare. <p>Evidencë 3.6 Programet e lëndëve; Evidencë shtesë. Tabela permbledhese aneks, Tabela 15.</p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin në dispozicion si dhe në takimet me personelin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, GVJ konstatoi se format dhe metodat e mësimdhënies vlerësohen në mënyrë periodike nga studentët nëpërmjet pyetësorëve. Më tej këto vlerësime u bëhen të njohura personelit akademik dhe analizohen nga njësia bazë dhe rezultatet e kësaj analize përdoren për përmirësimin në vazhdim të formave dhe metodave të mësimdhënies.</p> <p>Evidencë 5.7 Analizë mësimore shkencore; Evidencë 17. Analiza mesimore- shkencore 2022;</p>

duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Evidence 6.6-Pjesëmarrja e stafit në projekte; Evidence 5.3-Analizë e pyetësorëve të studentëve; Evidence 6.4-Formular për vlerësimin e pedagogut; Evidence 3.5 Rregullore e NJSBC, FSHN.			
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Studentët në veçanti në lëndët karakterizuese të këtij programi studimi, motivohen për projekte praktike individuale apo punime në grup, punime të cilat prezantohen përpara pedagogut të lëndës dhe studentëve të tjerë. Kjo mundëson zhvillimin e autonomisë së studentit i cili jo vetëm përvetëson njohuritë, por mëson edhe ti përçojë ato. Duke iu referuar CV-ve të personelit akademik, GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit Bachelor në “Informatikë” posedon eksperiencë dhe dhe kompetenca profesionale në mësimdhënie. Evidence 4.1 CV e stafit akademik; Evidence 5.7 Analizë mësimore shkencore; Evidence 6.6-Pjesëmarrja e stafit në projekte.			
Konkluzione	<ul style="list-style-type: none"> - GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në Rregulloren e Studimeve në USH dhe në rregulloret e FSHN dhe të programit të studimit.. - Syllabuset e lëndëve ju vihen në dispozicion studentëve nga pedagogu i lëndës/modulit në javën e parë të mësimin. - Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një lënde janë ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive, plotësimi i detyrimeve, si detyrë apo projekt kursi, testimet gjatë vitit dhe provimi përfundimtar. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e	Testimi dhe vlerësimi i njohurive, aftësive dhe kompetencave profesionale realizohet përgjatë vitit akademik me qëllim që studentët të jenë të angazhuar përgjatë semestrit dhe të vlerësohen sipas disa kriterëve të parashikuara në rregulloren e e studimeve në USH, rregulloren e FSHN dhe rregulloren e programit të studimit, në procedurat e vlerësimit të studentëve në funksion të përmbushjes së detyrimeve akademike dhe rritjes së cilësisë në mësimdhënie, sipas



Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 25





<p>lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>kritereve të parashikuara në syllabuset e lëndëve. Format e testimit dhe vlerësimit të dijeve për këtë program studimi gjatë zhvillimit të një lënde janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 3. Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive 10 % të notës përfundimtare; 4. Plotësimi i detyrimeve laborator apo detyrë kursi 10 % të notës përfundimtare; 5. Testimet gjatë vitit 20 % të notës përfundimtare; 6. Provimi përfundimtar 60 % të notës përfundimtare. <p>Këto forma testimi dhe vlerësimi u japin mundësinë të gjithë studentëve të shprehin aftësitë e tyre dhe të mbrojnë kompetencat e fituara gjatë procesit mësimor.</p> <p>Evidencë 2. Rregullore e studimeve në USH; Evidencë 1.6 Rregullore e FSHN; Evidencë 2.9 Rregullore studimesh Informatike; Evidencë 3.6 Programet e lëndëve; Evidencë shtesë. Tabela permbledhese aneks. Tabela 15.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Testimi dhe vlerësimi i njohurive në USH realizohet duke kombinuar metodat tradicionale (provimet me shkrim dhe ato me gojë), si dhe format elektronike si hartimi, dërgimi elektronik dhe prezantimi i detyrave/projekteve të kursit. Për disa kurrikula specifike në USH është përdorur dhe metoda elektronike e vlerësimit nëpërmjet projektit Cleanscore nga Fondi Shqiptaro - Amerikan i Zhvillimit</p> <p>Evidencë 3.6 Programet e lëndëve; Evidencë 21. Projekti cleanscore.</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Format e vlerësimit përfundimtar të lëndës janë të përcaktuara në rregulloren e studimeve në USH, rregulloret e FSHN dhe dhe të programit të studimit, si dhe në syllabusin përkatës të lëndës. Në të njëjtën kohë u bëhet e ditur studentëve në javën e parë mësimore nga pedagogu i lëndës.</p> <p>Evidencë 2. Rregullore e studimeve në USH; Evidencë 1.6 Rregullore e FSHN; Evidencë 2.9 Rregullore studimesh Informatike; Evidencë 3.6 Programet e lëndëve.</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Gjatë zhvillimit të lëndës stafi akademik gjatë orëve të seminareve u ofron studentëve komente /feedback për performancën e tyre lidhur me përvetësimin e njohurive gjatë seminareve/testimeve të ndërmjetme, nivelit të përgatitjes/prezantimeve të detyrave të kursit/projekteve, duke iu dhënë këshilla/orientime për përmirësimin e performancës në të ardhmen. Vlerësimi i komponentëve të vlerësimit përfundimtar shoqërohet me komente nga pedagogu/pedagogët e lëndës, ku qartësohen të gjitha kriteret e përdorura në vlerësim dhe studentët ballafaqohen me vlerësimin. Korrigjimi i provimit shoqërohet me komente në lidhje me gjetjet e pedagogut dhe arsyetimin e vlerësimit. Nga takimi me stafin akademik dhe studentët e programit të studimit u konstatua që në rastet e nevojshme, pedagogu/pedagogët e lëndës janë të gatshëm të japin mbështetjen dhe sqarimet shtesë të nevojshme për studentët që e kërkojnë këtë.</p>

	<p>Evidencë 2. Rregullore e studimeve në USH; Evidencë 1.6 Rregullore e FSHN; Evidencë 2.9 Rregullore studimesh Informatike; Evidencë 3.6 Programet e lëndëve.</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Në rregulloren e USH dhe kodin e etikës është përcaktuar moslejimi dhe janë përcaktuar masat që merren nga njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik që të shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. Departamenti dhe personeli akademik bazohen në rregulloren e provimit dhe të etikës lidhur me mënyrën e mbikëqyrjes, dhe të masave ndëshkuese në rast plagjiaturë gjatë procesit të provimit. Për sa i përket detyrave të kursit dhe kryesisht të punimeve të diplomave, personeli akademik dhe drejtuesit e departamentit të Matematikës dhe FSHN, orientojnë/miratojnë tematika kryesisht aplikative ose gjysmë aplikative, ku të dhënat që përdoren (kryesisht të punimet e diplomave) të jenë autentike. Për këto të fundit, përgjegjësinë kryesore për vlerësimin dhe shmangien e plagjiaturës e ka pedagogu udhëheqës. Testet e ndërmjetme dhe ai final administrohen nga prania në auditor e dy pedagogëve, të cilët janë përgjegjës për moslejimin e kopjimit.</p> <p>Evidencë 12 kodi i etikës së USH; Evidencë 2. Rregullore e studimeve në USH; Evidencë 1.6 Rregullore e FSHN; Evidencë 2.9 Rregullore studimesh Informatike; Evidencë 3.6 Programet e lëndëve.</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar bëhet në përputhje me në rregulloren e studimeve në USH, rregulloret e FSHN dhe të programit të studimit, si dhe sipas disa kriterëve të parashikuara për komponentët e vlerësimit në syllabuset e lëndëve. GVJ konstatoi, gjatë vizitës në sekretarinë mësimore që vlerësimi kryhet në bazë notash nga 1 në 10. Nota më e ulët kaluese është nota 5. Rezultatet e provimit ju bëhen të njohura studentëve pedagogu i lëndës në orën dhe sallën e dakordësuar paraprakisht me studentët. Gjatë vitit pedagogët janë të lirë të alternojnë metodat kontrolluese dhe vlerësuese të cilat përfshijnë kontroll të vazhdueshëm nëpërmjet provimeve, teste me pyetje alternative, quiz-e, prezantime në grup ose individuale, etj.</p> <p>Evidencë 2. Rregullore e studimeve në USH; Evidencë 1.6 Rregullore e FSHN; Evidencë 2.9 Rregullore studimesh Informatike; Evidencë 3.6 Programet e lëndëve.</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>GVJ konstatoi gjatë takimit me studentët se ata ishin të informuar mbi të drejtën e tyre për ankimim, kjo e përcaktuar edhe në rregulloren e studimeve në USH. Me shpalljen e rezultateve paraprake nga pedagogu, studenti ka të drejtën e kontestimit të mundshëm brenda afateve të përcaktuara në rregullore. Pas kontestimit të notës nga studenti, kërkesa e tij për rivlerësim shqyrtohet nga komisioni i provimit/pedagogu i lëndës të cilët vendosin për notën përfundimtare. Në rastet e vazhdimit të kontestimit të vlerësimit/notës studenti ka të drejtën e kontestimit duke iu drejtuar me kërkesë Dekanit të FSHN, i</p>

	cili pasi shqyrton kërkesën, në rast se pranohet, kërkesa analizohet nga një komision ad-hoc i ngritur me pedagog të lidhur me disiplinën që po vlerësohet (jo pedagogu i lëndës). Gjatë takimit me studentët e këtij programi studimi, GVJ konstatoi se studentët në përgjithësi merrnin përgjigje apo sqaronin çdo paqartësi të mundshme me pedagogët e lëndës pa patur nevojë të përshkallëzojnë kërkesat e tyre. Evidencë 2. Rregullore e studimeve në USH; Evidencë 1.6 Rregullore e FSHN; Evidencë 2.9 Rregullore studimesh Informatike; Evidencë 3.7 Procedurë ankimore e studentëve; Evidencë shtesë Vendim Dekani per Proces Permiresim Note.		
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se USH siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në rregullore, procedura dhe kriteret specifikë, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit në çdo rast të kërkuar, të cilat u bëhen të njohura studentëve.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	GVJ konstaton se program i studimit Bachelor në "Informatikë" synon t'i përgatisë dhe formojë studentët me njohuritë dhe kompetencat e nevojshme në programimin, zbatimin e aplikacioneve, komunikimin, menaxhimin e bazave të të dhënave, zhvillimin e softwareve, zhvillimin e website-ve, mediat dixhitale dhe mirëmbajtjen e tyre etj. GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës konstaton se plani mësimor i programit të studimit përfshin dhe lëndë karakterizuese në fushën e informatikës, si dhe përmbillet me provimin përfundimtar/punimin e diplomës. Në këtë program studimi është parashikuar lënda "Praktikë Profesionale", e cila ndihmon studentin të aplikojë në praktikë njohuritë e përftuara gjatë studimeve në një ambient real në tregun e punës. Departamenti i Matematikës mundëson për studentët krahas procesit mësimor dhe procesin e konsultimeve. Kjo kurrikul përgatit dhe mbështet studentët për thellimin e studimeve në ciklin master. Evidencë 2. Rregullore e studimeve në USH; Evidencë 1.6 Rregullore e FSHN; Evidencë 2.9 Rregullore studimesh Informatike; Evidencë 3.6 Programet e lëndëve.




<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Ky program studimi synon krijimin dhe zhvillimin e aftësive specifike dhe në fushën e komunikimit dhe ndërveprimit dhe aftësi të tjera të vecanta kurrikulare si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • lëndë për aftësimin në gjuhë të huaj (Anglisht dhe turqisht); • lëndë për aftësimin e ndërveprimit (Kulturë gjuhe); • lëndë për aftësi menaxhuese (Hyrje në ekonomi dhe Scrum Framework). <p>Pasi ato në fushën e TIK janë të thelluara dhe pjesë e programit të studimit.</p> <p>Evidence 2.9 Rregullore studimesh Informatike; Evidencë 2.1.1 Programi Bachelor në Informatikë; Evidencë 3.6 Programet e lëndëve.</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmblylëse.</p>	<p>Nga takimi me studentët e programit, rezulton se në fillim të semestrit, studentëve iu ofrohet informacion rreth mënyrës së organizimit të lëndës, objektivat e lëndës dhe rezultatet e pritshme. Metodot e testimit dhe vlerësimit të njohurive, aftësive dhe kompetencave profesionale ju bëhen të njohura studentëve, analizohen dhe vlerësohen në përfundim të lëndës. Në këtë mënyrë u vihen në vëmendje konceptet dhe çështjet më të rëndësishme, si dhe të orientohen studentët për aplikimin e tyre, si dhe detyrimet përmblylëse dhe vlerësimi i tyre sipas kriterëve të parashikuara dhe prezantuar në syllabuset e lëndëve. GVJ u informua gjatë takimit me stafin akademik se nga ana e tyre në mënyrë të vazhdueshme mbështeten, orientohen dhe udhëzohen studentët në realizimin e detyrave të caktuara, pjesë e programeve mësimore të lëndëve të ndryshme. Detyrat/projektet e kursit në lëndët përkatëse janë një mundësi reale për zhvillimin e punës në grup. Gjithashtu në javët e fundit, pedagogët e lëndës informojnë studentët mbi kompetencat e fituara që duhet të demonstrojnë në provim. Studentët orientohen në lidhje me strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë provimi final dhe gjithashtu edhe për peshën që do të ketë në notën finale të modulit provimi final.</p> <p>Evidence 2.9 Rregullore studimesh Informatike; Evidencë 3.6 Programet e lëndëve.</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e — problemeve/çështjeve — të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato;</p>	<p>GVJ vlerëson se personeli akademik i programit të studimit Bachelor në "Informatikë" transmeton dijet e tyre tek studentët duke demonstruar njohuritë dhe duke kryer praktika dhe testime laboratorike së bashku me studentët. Gjatë zhvillimit të orëve mësimore, studentët realizojnë prezantime apo detyra kursi dhe projekte të ndryshme të parashikuara dhe në syllabuset e të gjitha lëndëve. Studentët aplikojnë njohuritë e marra gjatë lëndëve në praktikat lëndore dhe profesionale. Gjatë takimeve me stafin akademik dhe studentët, GVJ evidentoi se personeli akademik i programit të studimit Bachelor në "Informatikë" në mënyrë të vazhdueshme mbështet, orienton dhe instrukturon studentët në realizimin e detyrave të caktuara, pjesë e programeve mësimore të lëndëve të ndryshme. Detyrat/projektet e kursit në lëndët përkatëse janë një mundësi reale për zhvillimin e punës në grup për raste interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve të zbatimit real, në të cilat personeli akademik nxit studentët që ta trajtojnë studimin dhe gjetjen e zgjidhjes duke punuar në grup. Në të njëjtën kohë USH ka</p>

<p>ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe shkëmbimi më IAL në vend dhe jashtë, si dhe në kuadër të projekteve ERASMUS +, exchange dhe mobilitet. Në këtë program studimi ka pasur disa studentë që kanë qenë përfitues të mobiliteteve. <u>Aktualisht nuk ka projekte ERASMUS +, exchange dhe mobilitet aktive në këtë program studimi.</u> <u>GVJ rekomandon që USH të shtojë angazhimin dhe aplikimet për këto projekte pasi mbështesin përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie dhe në mësimnxënie në programin e studimit, si dhe realizimin e programit të studimit.</u></p> <p>Evidencë 5.7 Analizë mësimore shkencore; Evidencë 17. ANALIZA MESIMORE- SHKENCORE 2022; Evidencë 6.6 Pjesëmarrja e stafit në projekte; Evidencë shtesë Minuta takimi Bsc. Matematike dhe Bsc. Informatike; Evidencë 36. Marrëveshjet e bashkëpunimit në rang universiteti.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se njësia bazë dhe njësia kryesore dhe stafi akademik përgjegjës për këtë program studimi <u>nuk kanë realizuar leksione të hapura, trajnime apo seminare informuese të mjaftueshme për studentët e këtij programi studimi.</u> Këto aktivitete mund të drejtohen nga personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar), përfaqësues biznesesh, ekspertë të ndryshëm etj. <u>GVJ rekomandon rritjen e numrit të bashkëpunimeve me kompanitë private, në vend dhe jashtë, si dhe institucionet publike, kjo në mbështetje të realizimit të praktikave mësimore, si dhe organizimit të orëve të hapura, seminareve shkencore dhe profesionale mbi zhvillimet e reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</u></p> <p>Evidencë 3.13-Orë e hapur AlbaNSI; Evidencë 19. Rvb institucionale 2022; Evidencë 36. Marrëveshjet e bashkëpunimit në rang universiteti.</p>
<p>Konkluzione</p>	<ul style="list-style-type: none"> - <u>GVJ konstaton se njohuritë që ofrohen nga ky program dhe kompetencat që studentët fitojnë përmes tij, u japin mundësinë të ndjekin edhe një karrierë kërkimore e akademike në një cikël më të lartë, për të rritur statusin e tyre profesional dhe përbushjen e objektivave personale.</u> - <u>USH ka ndërtuar ura komunikimi dhe bashkëpunimi me disa universitete në kuadër të marrëveshjeve ekzistuese për rritjen e kapaciteteve të stafit akademik dhe studentëve. Aktualisht nuk ka projekte ERASMUS +, exchange dhe mobilitet aktive në këtë program studimi. GVJ rekomandon që USH të shtojë angazhimin dhe aplikimet për këto projekte pasi mbështesin përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie dhe në mësimnxënie në programin e studimit, si dhe realizimin e programit të studimit.</u> - <u>GVJ rekomandon rritjen e numrit të bashkëpunimeve me kompanitë private, në vend dhe jashtë, si dhe institucionet publike, kjo në mbështetje të realizimit të praktikave mësimore, si dhe organizimit të orëve të hapura, seminareve shkencore dhe profesionale mbi zhvillimet e reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</u>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Aktet e brendshme rregullatore, në rregulloret e USH dhe FSHN paraqesin qartë procesin e diplomimit të studentëve që studiojnë dhe në këtë program studimi. Në rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Informatikë” jepet procedura më specifike për provimin final dhe në raste të veçanta mbrojtjen e diplomës para diplomimit. USH ka hartuar kërkesat e diplomimit që i bëhen të ditura studentit nga Departamenti i Matematikës. Komisioni dhe kryetari i komisionit për provimin përfundimtar ose mbrojtjen e diplomës caktohen nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe miratohen nga Dekani. Kryetari i komisionit në bashkëpunim me anëtarët plotësojnë një program tematikash për lëndën e provimit të përgjithshëm përfundimtar. Stafi i brendshëm akademik i DM përgatit dhe informon studentët për tematikat për punimet e diplomave, së bashku me udhëzimet e përgatitjes së punimit.</p> <p>Evidencë 2. Rregullore e studimeve në USH; Evidencë 1.6 Rregullore e FSHN; Evidencë 2.9 Rregullore studimesh Informatike.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Departamenti i Matematikës harton, në bashkëpunim me të gjithë stafin akademik, një fond pyetjesh orientuese për studentët për përgatitjen e tyre për provimin përfundimtar të diplomimit, të cilat u vihen në dispozicion studentëve nga zyra e informimit pranë njësisë kryesore. Gjithashtu, studentët që plotësojnë kriteret e përcaktuara në rregulloren e programit të studimit, me mesatare të studimeve mbi 8.5 mund të diplomohen me një punim diplome. Departamenti i Matematikës përcakton stafin akademik për udhëheqjen e diplomave, të cilët kanë rol kyç në mentorimin, kontrollin dhe vlerësimin e ecurisë së punimit deri në diplomim të studentit.</p> <p>Evidencë 1.6 Rregullore e FSHN; Evidencë 2.9 Rregullore studimesh Informatike. Evidencë 3.8 Akti i krijimit të komisionit të diplomës Bachelor; Evidencë 3.9 Paketa e udhëzimeve për mbrojtjen e temës së ciklit të parë (Bachelor); Evidencë 3.10 Programi i provimit të formimit _Informatika 2022 – 2023; Evidencë 3.11 Vendime udhëheqje diplome; Evidencë 3.12 Shembull teze provim formimi.</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e</p>	<p>GVJ konstaton se në rregulloren e USH përcaktohet se teza e provimit të përgjithshëm përfundimtar është e përbërë nga grupe të ndryshme</p>

<p>provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>pyetjesh të përgatitura nga lëndët teknike që studentët kanë ndjekur gjatë studimeve. Përqindja e secilit grup pyetjesh përcaktohet në bazë të ngarkesës së lëndës (krediteve) në programin e studimit dhe raportit të tyre me lëndët e tjera. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit të përgjithshëm përfundimtar përgatit tezen për provimin e përgjithshëm përfundimtar bazuar në pyetjet e paraqitura nga secili pedagog i përfshirë në proces, duke ruajtur përqindjen e përcaktuar.</p> <p>Evidencë 1.6 Rregullore e FSHN; Evidencë 2.9 Rregullore studimesh Informatike. Evidencë 3.8 Akti i krijimit të komisionit të diplomës Bachelor Evidencë 3.10 Programi i provimit të formimit_Informatika 2022 – 2023; Evidencë 3.12 Shembull teze provim formimi.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Departamenti i Matematikës ka përcaktuar stafin akademik për udhëheqjen e diplomave përgjegjës për mbikëqyrjen dhe udhëzimin e studentëve gjatë procesit të përgatitjes së punimit të diplomës është udhëheqësi i diplomës, i cili ka rol këshillues/udhëzues për studentin në realizimin e punimit të diplomës, por edhe pedagogë të tjerë, specialistë të fushave përkatëse për të kontribuar më mirë në përgatitjen e një punimi cilësor, në të përfshihet edhe stafi ndihmës akademik. Udhëheqësit e punimit të diplomës udhëzojnë studentët në procesin e kryerjes së hulumtimit dhe shkrimit të punimit, garantimin e cilësisë së punimit dhe rezultateve, si dhe miratimin e punimit final të diplomës për tu prezantuar para komisionit të diplomimit. Mbështetja e USH përfshin edhe vënien në dispozicion të studentit të ambienteve laboratorike dhe fondin e bibliotekës fizike, dhe bazuar edhe në programet e ndryshme të studimit që ofrohen.</p> <p>Evidencë 1.6 Rregullore e FSHN; Evidencë 2.9 Rregullore studimesh Informatike;</p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Evidencë 3.9 Paketa e udhëzimeve për mbrojtjen e temës së ciklit të parë (Bachelor); Evidencë 3.11 Vendime udhëheqje diplome;</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Studentët vlerësohen me notë, që pasqyron performancën e tyre kërkimore e shkencore në punimin e diplomës.</p> <p>Evidencë 1.6 Rregullore e FSHN; Evidencë 2.9 Rregullore studimesh Informatike.</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë</p>	<p>GVJ konstaton se USH ka të miratuar formën e regjistrimit të diplomës me Urdhër QSHA Nr. 264, datë 28.05.2021. Në përfundim të studimeve studentit pajisjet me diplomën dhe suplementin e saj.</p> <p>Evidencë 3.14 Modeli i diplomës dhe suplementi bachelor.</p>

zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.				
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Në sekretarinë mësimore dhe në atë të njësisë kryesore, ruhet i gjithë dokumentacioni për procesin mësimor të çdo viti akademik, që arkivohen sipas akteve ligjore në fuqi. Në rastet kur studenti pas diplomimit kërkon, ai mund të pajiset me dublikata të dokumentacioneve që kanë qenë në fuqi në periudhën kur ka qenë student pranë këtij institucioni. Evidencë 2. Rregullore e studimeve në USH.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se USH ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të provimit të përgjithshëm përfundimtar /diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin e nevojshëm pas diplomimit, i cili arkivohet sipas rregullores së IAL.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1																																																								
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.																																																								
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																							
<p>Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>GVJ konstaton se personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit Bachelor në Informatikë plotëson kërkesat ligjore në fuqi. Për të mbuluar lëndët mësimore të programit Bachelor në Informatikë është angazhuar staf akademik me përgatitje specifike në atë fushë. Fakulteti i Shkencave të Natyrës gjatë vitit akademik 2022-2023 ka patur 51 anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë me kualifikimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 3 Profesor - 8 Profesor i Asociuar; - 19 Doktorë shkencash; - 21 MSc. (nga të cilët, 2 Dr. në proces). <p>Stafi akademik i Departamentit të Matematikës (sipas Tabela 2) përbëhet nga 14 anëtarë personel akademik efektiv, me kualifikimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 4 Doktor - 10 MSc <p>Në tre vitet e fundit akademike (sipas Tabela 6) kemi këtë paraqitje të angazhimit të stafit akademik në këtë program studimi sipas kualifikimeve.</p> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse; text-align: center;"> <thead> <tr> <th rowspan="2"></th> <th colspan="2">2022-2023</th> <th colspan="2">2021-2022</th> <th colspan="2">2020-2021</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr.</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof.Asoc.Dr.</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Dr./PhD</td> <td>3</td> <td>-</td> <td>4</td> <td>-</td> <td>4</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>MSc (Dr. në proces)</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>MSc</td> <td>9</td> <td>4</td> <td>5</td> <td>4</td> <td>5</td> <td>7</td> </tr> <tr> <td>Total</td> <td>12</td> <td>5</td> <td>9</td> <td>5</td> <td>9</td> <td>8</td> </tr> </tbody> </table> <p>Gjatë vizitës në institucion, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u njoh me vështirësitë e institucionit për të rekrutuar staf të kualifikuar. Programi Bachelor në Informatikë mbulohet nga një numër i lartë stafi akademik PAK me gradën shkencore MsC, (tabela 6.3). Në planin mësimor të programit të studimit janë cilësuar edhe titullarët e lëndëve, shumica e</p>		2022-2023		2021-2022		2020-2021		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr.	-	-	-	1	-	1	Prof.Asoc.Dr.	-	1	-	-	-	-	Dr./PhD	3	-	4	-	4	-	MSc (Dr. në proces)	-	-	-	-	-	-	MSc	9	4	5	4	5	7	Total	12	5	9	5	9	8
	2022-2023		2021-2022		2020-2021																																																			
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																		
Prof.Dr.	-	-	-	1	-	1																																																		
Prof.Asoc.Dr.	-	1	-	-	-	-																																																		
Dr./PhD	3	-	4	-	4	-																																																		
MSc (Dr. në proces)	-	-	-	-	-	-																																																		
MSc	9	4	5	4	5	7																																																		
Total	12	5	9	5	9	8																																																		




	<p>të cilëve me gradën shkencore Master, jo në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p> <p>Kujtojmë se për zhvillimin e leksioneve në auditor, personeli akademik duhet të jetë i kategorisë “lektor”, pra të ketë së paku gradën shkencore “Doktor”, ndërsa në zhvillimin e aktiviteteve didaktike si seminare, laborator etj, personeli akademik që angazhohet duhet të ketë së paku formimin e një cikli më të lartë se ai programit të studimit ku angazhohet. Në rastin e këtij programi studimit, duhet të jetë së paku me kualifikimin “Master i Shkencave”.</p> <p><u>GVJ rekomandon që institucioni të përcaktojë titullarët e lëndëve me kualifikimet konform ligjit 80/2015 për arsimin e lartë dhe ti paraqesë ato në syllabuset e lëndëve.</u></p> <p>Evidencë 4.1. CV te stafit Akademik; Evidencë 2.1.1-Programi Bachelor në Informatikë; Evidencë 4.5-Kontratrat pedagogë të brendshëm.pdf Evidencë shtesë Tabela permbledhese aneks, Tabela 1/1, 1/2, 1/3, Tabela 2, Tabela 6.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vërejmë që garkesa e personelit akademik, është përcaktuar në respekt të lirisë akademike dhe në përputhje me ekspertizën përkatëse të stafit akademik. Departamenti i Matematikës planifikon çdo vit ngarkesën mësimore për të gjithë anëtarët e personelit akademik, mbështetur në normat e ngarkesës mësimore të përcaktuara në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet cilësore të Universitetit “Luigj Gurakuqi”. Ngarkesa mësimore e personelit akademik është me përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Programi i studimit Bachelor në Informatikë është i mbuluar në masën 85% nga staf akademik i brendshëm.</p> <p>Evidencë shtesë Tabela permbledhese aneks – Tabela 12; Evidencë 2.1 Programi Bachelor në Informatikë.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) zhvilloi takim me përfaqësues të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore. Gjatë këtij takimi, GVJ konstatoi se institucioni disponon dokumentacion të plotë për çdo anëtar të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, si dhe personelit ndihmës akademik dhe administrativ të angazhuar në këtë program studimi. Cdo anëtar i personelit akademik me kohë të plotë në Departamenti i Matematikës ka një kontratë pune me afat të pacaktuar kur është i kategorisë lektor dhe profesor dhe me afat të caktuar për kategorinë asistent lektor sipas përcaktimeve ligjore në fuqi dhe statutit të IAL. Të dhënat e personelit akademik mblidhen, ruhen dhe përditësohen nga zyra e Burimeve Njerëzore e cila krijon Dosjen Individuale të stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme ku depozitohet i gjithë informacioni së bashku me kontratat e punës dhe sigurimet shoqërore dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p> <p>Evidencë 1. Statuti USH; Evidencë 4.5 Kontratrat pedagogë të brendshëm.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe</p>	<p>Rekrutimi i personelit akademik në FSHN - USH realizohet në përputhje me bazën ligjore në fuqi, me rregulloren dhe statutin e</p>

<p>vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>institucionit. IAL garanton cilësinë e personelit akademik dhe zbaton procedura të ndershme dhe transparente për rekrutimin dhe zhvillimin e personelit akademik. Zyra e Burimeve Njerezore është përgjegjëse për konkurset për marrjen dhe pranimin e punonjësve në punë, plotësimin e tyre me librezat e punës si dhe për plotësimin e dosjes personale me dokumentacionin e nevojshëm për çdo punonjës të institucionit. Punësimi i personelit akademik dhe ndihmës-akademik kryhet me konkurim, përmes thirrjeve të hapura sipas kritereve të përcaktuara nga Njësia Bazë. Për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve ngrihet një komision ad-hoc i cili vlerëson kandidatët në dy faza: përmes vlerësimit të dosjes dhe përmes intervistës. Institucioni ka paraqitur evidencë në lidhje me procedurën e rekrutimit dhe vlerësimit të stafit akademik. Procedura që ndjek USH është transparente dhe garanton përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit.</p> <p>Evidencë 1. Statuti USH; Evidencë 11. Rregullore e punesimit; Evidencë 4.3 Shembull hartimi kriteresh për PAE në Informatikë; Evidencë 12. Kodi i etikes se USH.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në vizitën në institucion, GVJ konstaton se zhvillimi i seancave laboratorike mbështetet nga staf ndihmës akademik (laborant). FSHN ka angazhuar një (laborant) me Msc përgjegjes për laboratorin i cili kontribuon në mirëmbajtjen dhe ndihmon stafin akademik gjatë zhvillimit të orëve laboratorike. Gjatë vizitës në institucion, laboranti i FSHN na njohu me laboratorin dhe me infrastrukturën laboratorike.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ zhvilloi takim me përfaqësuesen e Zyrës së Burimeve Njerezore. Gjatë këtij takimi dhe në bazë të dokumentacionit që u vu në dispozicion, GVJ konstaton se institucioni disponon dokumentacion të plotë për çdo anëtar të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, si dhe personelit ndihmës mësimor dhe administrativ të angazhuar në këtë program studimi, që përfshin: diplomat, certifikat e ndryshme, vërtetimet për gradat akademike, CV-të, kontratat e punës, librezë shëndetsore, dëshmia e anglishtes, kërkesa e punësimit etj. Të dhënat e stafit efektiv dhe atij me kontratë administrohen nga Zyra e Burimeve Njerezore në nivel institucional dhe nga njësia kryesore dhe njësitë bazë për program studimi. Informacioni administrohet duke respektuar konfidencialitetin e të dhënave personale dhe arkivohet konform akteve rregullatore institucionale. Në përfundim të vitit akademik, nga Zyra e Burimeve Njerezore administrohen edhe evidencat e detajuara për plotësimin e orëve mësimore. GVJ përmes dokumentacionit të paraqitur nga USH dhe takimeve të zhvilluara konstaton korrektësi në zbatimin e procedurës së administrimit të të dhënave të personelit akademik dhe ndihmës-akademik të angazhuar në këtë program studimi.</p> <p>Evidencë 11. Rregullore e punesimit;</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 36

	Evidencë 4.3 Shembull hartimi kriteresh për PAE në Informatikë; Evidencë 12. Kodi i etikës së ush.			
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	<p>Bashkëpunimet e USH me industrinë, biznesin, dhe institucione të tjera të arsimit të lartë mbështeten në marrëveshje të institucionalizuara.</p> <p>FSHN mbështetet në këto marrëveshje bashkëpunimi për të përmbushur objektivat e lëndëve praktike të planit mësimor.</p> <p>Këto marrëveshje përdoren edhe për realizim të praktikave profesionale të studentëve, të cilat janë pjesë e planit mësimor dhe zënë 5 kredite ECTS. IAL ofron gjithashtu edhe trajnime/workshope profesionale që mbështeten nga bizneset partnere me të cilat bashkëpunon institucioni.</p> <p>Evidencë 36. Marrëveshjet e bashkëpunimit në rang universiteti; Evidencë 1.7 Marrëveshje praktika AL; Evidencë 3.13 Orë e hapur AlbaNSI; Evidencë 1.8 Model i vlerësimit të Praktikës Profesionale.</p>			
Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritis që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	<p>Ky program studimi ka të parashikuar lëndën e “Praktikës Profesionale” e cila realizohet në vitin e tretë të studimeve Bachelor në Informatikë në përfundim të së cilës studenti fiton 5 kredite ECTS. Praktika profesionale realizohet si aktivitet i mbështetur në marrëveshjet e bashkëpunimit që USH ka me institucione publike apo private. Njësisia bazë cakton një pedagog udhëheqës që asiston studentin dhe garanton cilësinë e rezultateve duke qënë i pranishëm në komisionin e praktikës profesionale.</p> <p>Evidencë 2.1 Programi Bachelor në Informatikë; Evidencë 1.8 Model i vlerësimit të Praktikës Profesionale.</p>			
Konkluzione	<ul style="list-style-type: none"> - IAL dëshmon njetrajtshmëri të numrit të personelit akademik në tre vitet e fundit. - Programi i studimit Bachelor në Informatikë është i mbuluar në masën 85% nga staf akademik i brendshëm. - Procedura që ndjek USH për rekrutimin e stafit akademik dhe ndihmës akademik është transparente dhe garanton përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit për pozicionin e punës. - Stafit akademik që mbulon programin e studimit është në pjesën më të madhe me gradën shkencore Master. - <u>Informacioni në lidhje me titullarët e lëndëve të paraqitura në planin mësimor nuk korespondon me titullarët e lëndëve në sylabuset e lëndëve. Rekomandohet që titullarët e lëndëve të paraqiten vetëm në sylabuset e lëndëve dhe jo në planin mësimor.</u> - <u>GVJ rekomandon që institucioni të përcaktojë titullarët e lëndëve me kualifikimet konform ligjit 80/2015 për arsimin e lartë dhe ti paraqesë ato në sylabuset e lëndëve.</u> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	<p>Procesi mësimor në programin e studimit Bachelor në “Informatikë” zhvillohet në dy godina të ndryshme se bashku me një sipërfaqe totale rreth 7000 m². Mjediset e brendshme të godinës sigurojnë salla leksioni, seminari, laboratorë, bibliotekë, zyra dhe mjedise për studentët. Aktiviteti mësimor për programin e studimit Bachelor “Informatikë”, zhvillohet në 3 laboratore dhe 2 salla leksioni, 3 salla seminari dhe 10 nyje hidrosanitare. GVJ gjatë vizitës në institucion vizitoi ambientet ku zhvillon mësimin programi Bachelor “Informatikë” dhe konstaton që godina e FSHN është funksionale për zhvillimin e aktivitetit mësimor.</p> <p>Evidencë 4.7 Informacion infrastruktura dhe ambiente; Evidencë 3.1 Foto laboratore; Evidencë 3.1 Infrastruktura laboratore.</p>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi që ambientet ku zhvillon mësim FSHN janë të pajisura me mjete elektronike që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies e mësimnxënies. Konkretisht, FSHN zotëron 3 laboratorë, të pajisura me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin sa më modern të procesit mësimor (tabelë smart, videoprojektor dhe shërbim interneti, etj) dhe një sallë serverash. Çdo laborator është i pajisur me 20-30 poste pune të pajisura me PC me programe software të përshtatshme sipas planit mësimor. Instalimi, mirëmbajtja dhe azhurnimi i pajisjeve kompjuterike bëhet një laborant i dedikuar për mirëmbajtjen teknike të secilit laborator.</p> <p>Evidencë 4.7 Informacion infrastruktura dhe ambiente; Evidencë 3.1-Foto laboratore; Evidencë 3.1 Infrastruktura laboratore; Evidencë RVB-Perfundimtare.</p>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	<p>FSHN vë në dispozicion të programit të studimit Bachelor “Informatikë” 3 laboratorë dhe 1 sallë serveri. Laboratorët mbështesin lëndët përkatëse të cilat mbulohen nga stafi akademik i programit të studimit “Bachelor në Informatikë”. Secili laborator është i pajisur me 20-30 PC me parametra të përshtatshëm për të instaluar programet e nevojshme që aftësojnë studentët në fushën e programimit kompjuterik, në fushën e rrjetave dhe sistemeve operative. Laboratorët janë përkatësisht në përdorim për grup lëndët:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Laborator 1: Hyrje në Informatikë, Strukturë të dhënash, C++, Python


	<p>2. Laborator 2: Web, Bazë të dhënash, Java, Programim Windows</p> <p>3. Laborator 3: Rrjetat.</p> <p>GVJ vizitoi ambientet e laboratorëve të FSHN dhe u njoh nga afer me pajistet teknike në mbështetje të mësimdhënies dhe praktikave profesionale dhe sugjeron që IAL të ketë në vëmendje pëditësimin e vazhdueshëm të laboratorëve të informatikës në mënyrë që të reflektojnë zhvillimet e shpejta teknologjike.</p> <p>Evidence 3.1 Foto laboratore; Evidence 3.1 Infrastruktura laboratore; Evidencë RVB-Perfundimtare.</p>								
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Në bazë të specifikës së programit të studimit Bachelor në Informatikë, FSHN vë në shërbim të studentëve 3 laboratorë dhe një dhomë serveri të cilët janë të pajisur me software dhe hardware që mbështesin studentët në aftësimin e tyre praktik.</p> <p>Sipas natyrës së grup lëndëve që mbështesin laboratorët janë organaizuar si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Laborator 1: Hyrje në Informatikë, Strukturë të dhënash, C++, Python 2. Laborator 2: Web, Bazë të dhënash, Java, Programim Windows 3. Laborator 3: Rrjetat. <p>Evidencë 3.1 Infrastruktura laboratore.</p>								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Universiteti i Shkodrës vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturë të mjaftueshme për realizimin e procesit mësimor të programit të studimit dhe për formimin praktik.</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p>Standardi IV.3</p> <p>IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Literatura e bazë e kurseve ofrohet në gjuhën e programit të studimit (shqip). Në rastin kur nuk ka një botim me ISBN në gjuhën shqipe për lëndën atëherë si literaturë bazë shërben një cikël leksionesh nga titullari dhe lektorët e lëndës. Literatura bazë është e evidentuar qartë në syllabusin e lëndës dhe i vihet në dispozicion studentëve në format elektronik nga pedagogu i lëndës dhe/ose në format fizik në bibliotekën e USH. Literatura ndihmëse është kryesisht në gjuhë të</p>

	<p>huaj (anglisht). Kjo literaturë është e përshtatshme për të dhënë njohuritë e kërkuara suplementare për këtë program studimi.</p> <p><i>GVJ konstaton që literatura e rekomanduar nuk është e viteve të fundit dhe sugjeron që t'i kushtohet më shumë kujdes përzgjedhjes së literaturës ndihmëse me autorët më të spikatur të fushave përkatëse dhe kjo literaturë të përfshihet edhe në fondin e bibliotekës.</i></p> <p>Evidencë 2.14 Literatura e Informatikës; Evidencë 3.6 Programet e lëndëve.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Përditësimi i literaturës bazë dhe ndihmëse për lëndët bëhet cdo fillim viti akademik nga titullari i lëndës sipas përcaktimeve në Nenin 9, pika 2 të rregullores së studimeve për Programet Mësimore. Pas miratimit të programeve mësimore të lëndëve nga njësia bazë, ato dërgohen në formë elektronike në degën e kurrikulave nga Dekani i FSHN. Në IAL nuk ka procedurë të miratuar për planifikimin e buxhetit për literaturën me botime të viteve të fundit të programit të studimit dhe fondin e nevojshëm të literaturës në bibliotekë. <u>Në IAL nuk ka procedurë të miratuar për planifikimin e buxhetit për pasurimin e literaturës literaturës me botime të viteve të fundit në funksion të programit të studimit dhe fondin e nevojshëm të literaturës në bibliotekë.</u></p> <p><i>GVJ rekomandon përcaktimin e procedurës në aktet rregullatore të IAL dhe njoftimin e personelit akademik dhe administrativ të përfshirë.</i></p> <p>Evidencë 2.9 Rregullore studimesh Informatike; Evidencë 2.14 Literatura e Informatikës; Evidencë 3.6 Programet e lëndëve; Evidencë Përgjigje ASCAL-Dokument Sqarues.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në Universitetin e Shkodrës, GVJ vizitoi ambientet e Bibliotekës, e cila arkivon, digjitalizon dhe mirëmban pasurinë akademike, kulturore e shkencore të Institucionit. Ajo është në shërbim të plotë të studentëve, pedagogëve, e studiuesve.</p> <p>Godina aktuale e bibliotekës, një godinë me tre kate dhe me sipërfaqe rreth 3000 m² është e pajisur me rafta librash me gjatësi 8 km linear me kapacitet mbajtës deri në 400 mijë libra. Biblioteka ka në fondin e saj rreth 111 000 tituj në gjuhën shqipe dhe të huaj, në formatin letër dhe elektronik. Gjithashtu, ofron mundësi kërkimi të informacionit on-line, në sallën e leximit, mundësi shfletimi të literaturës elektronike, pranë kompjuterave të sallës, si edhe lehtësi në kërkimin bibliografik të informacionit. Në shërbim të programit të studimit të Informatikës janë 278 njësi bibliotekare.</p> <p>Evidencë RVB-Perfundimtare; http://bush.unishk.edu.al/biblioteka/.</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe</p>	<p>Biblioteka universitare ofron literaturë, tekste mësimore dhe plotësuese që mbështesin kurrikulat mësimore. Krahas librit fizik, ekziston edhe libri elektronik. Biblioteka universitare është hibride dhe me fonde të hapura.</p>

<p>dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Në shërbim të programit të studimit të Informatikës janë 278 njësi fizike bibliotekare dhe biblioteka të tjera jashtë vendit me të cilat shkëmbehet informacion.</p> <p>Evidence 2.13-Shkresa përcjellëse BUSH; Evidence 2.14-Literatura e Informatikës.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Studentët dhe stafi i USH kanë akses në një sistem menaxhimi të bibliotekës. GVJ vlerëson pozitivisht bibliotekën e USH-së që ndihmon komunitetin e USH-së të kërkojë libra online, të shkarkojë falas artikuj shkencorë, libra elektronike, disertacione, etj. Pjesë e bibliotekës është edhe Mediateka e pajisur me 30 vende multimedia (kompjuterët e kësaj sale janë dhuratë e Qeverisë Austriake dhe e Universitetit të Firences (përmes projektit “Tempus Phare”).</p> <p>Bibliotekës e USH ve në dispozicion të studentëve, stafit akademik dhe kërkuesve disa katalogë online si: Katalogu Botëror WorldCat, Katalogu përmbledhës i bibliotekave të Francës – CCFr, Katalogu i Bibliotekës Kombëtare të Gjermanisë, Katalogu përmbledhës i bibliotekave të Italisë, Katalogu i Bibliotekës Kombëtare të Spanjës, Katalogu i Bibliotekës Britanike, Katalogu i Bibliotekës së Kongresit Amerikan, Index Translationum.</p> <p>Gjithashtu Biblioteka ka në shfrytëzim edhe platformën U-library të ofruar nga RASH.</p> <p>http://bush.unishk.edu.al/instrumente/kataloge-online/; Evidencë 26. Libraria dixhitale, u- library revistat elektronike.</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Pjesë e bibliotekës është mediateka e pajisur me 30 vende poste pune kompjuterike dhuratë e Qeverisë Austriake dhe e Universitetit të Firences, përmes projektit “Tempus Phare”.</p> <p>Në Mediatekë ka 24 vende multimedia në të cilën ndodhen 21 kompjutera në shërbim të studentëve me internet falas që iu vjen në ndihmë për përgatitjen e detyrave të kursit dhe diplomave. Interneti falas në këtë mjedis krijon kushte të favorshme për një studim online, mundëson konsultimin me materiale të ndryshme shkencore si dhe të mësuarin në distancë.</p> <p>Në mjedisin e Mediatekës ndodhet dhe fondi i materialeve jo libër (kaseta, cd dhe dvd). Numërohen rreth 700 materiale multimediale.</p> <p>http://bush.unishk.edu.al/sherbimet/mediateka/; Evidencë 26. Libraria dixhitale, u- library revistat elektronike.</p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave,</p>	<p>Biblioteka e USH funksionon në orarin 08:00-19:00 nga e hëna në të premte dhe në orarin 08:00-13:00 ditën e shtunë. Orari i punës në bibliotekë shpallet në mjediset e institucionit dhe në faqen ueb të universitetit. Biblioteka u përgjigjet nevojave të programeve të studimit me 13 punonjës të bibliotekës në rolet: përgjegjës, klasifikator, bibliograf dhe bibliotekar. GVJ vlerëson që Biblioteka ofron shërbim të specializuar që përballon nevojat e studentëve për</p>

numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	shërbim dhe shfrytëzim të mjediseve për punë -në grup apo prezantime. http://bush.unishk.edu.al; Evidencë RVB-Perfundimtare.			
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Çdo vit akademik parashikohen fonde për blerjen e literaturës shkencore bazuar në kërkesat e faulteteve të USH. Pasurimi i bibliotekës nuk është periodik, por varet nga mundësitë buxhetore të USH dhe kryhet nëpërmjet: blerjeve, dhurimeve, shkëmbimit të materialeve mes bibliotekave, artikujve shkencorë, tezave dhe dizertacioneve. GVJ gjatë vizitës në institucion vlerësoi punën e bibliotekës së USH si një njësi në shërbim jo vetëm të universitetit por të të gjithë komunitetit, por nuk mund të gjykojë në lidhje me shkallën e shfrytëzimit të infrastrukturës fizike dhe fondit të saj pasi IAL nuk ka paraqitur evidencë për këtë. Evidencë 28. Lista e blerjeve nga bush 2021- 2022.			
Konkluzione	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Biblioteka u përgjigjet nevojave të programeve të studimit me staf të kualifikuar, ambiente infrastrukturore moderne dhe fond ekzistues fizik dhe elektronik.</i> - <i>GVJ konstaton që literatura e rekomanduar nuk është e viteve të fundit dhe sugjeron që t'i kushtohet më shumë kujdes përzgjedhjes së literaturës ndihmëse me autorët më të spikatur të fushave përkatëse dhe kjo literaturë të përfshihet edhe në fondin e bibliotekës.</i> - <i>Në IAL nuk ka procedurë të miratuar për planifikimin e buxhetit për pasurimin e literaturës me botime të viteve të fundit në funksion të programit të studimit dhe fondin e nevojshëm të literaturës në bibliotekë.</i> - <i>GVJ rekomandon përcaktimin e procedurës në aktet rregullatore të IAL dhe njoftimin e personelit akademik dhe administrativ të përfshirë.</i> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	




Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar ne RVB, GVJ konstatoi që Fakulteti i Shkencave të Natyrës në USH ka në përdorim programin informatik të menaxhimit të të dhënave Pitagora të zhvilluar dhe administruar nga RASH i cili aksesohet online në https://ushk.pitagora.rash.al/login.</p> <p>Sistemi Pitagora është në ndihmë të institucionit për administrimin e të gjithë informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim.</p> <p>Pasi kandidati fiton statusin e studentit, regjistrohet në sekretarinë mësimore të fakultetit duke paraqitur dokumentacionin e nevojshëm si edhe duke respektuar afatet e përcaktuara nga MASR dhe më pas pajiset me një ID me anë të të cilës identifikohet dhe logohet në sistemin Pitagora. Mbështetur në legjislacionin në fuqi dokumentacioni themelor për studentët është: regjistri themeltar i studentit, regjistri i akademike të studentit dhe regjisri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave. Këto regjistra ruhen pas diplomimit në Arkivën e Shtetit Shqiptar, arkivën e USH-së si kopje e njëhësuar me origjinalin në formë hardcopy dhe elektronike.</p> <p>Evidencë 23. Platforma pitagora: Evidencë RVB-Perfundimtare.</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemet e menaxhimit të informacionit në USH përdoren në pëpëthje me statutin e USH-së dhe Rregulloren e Njësisë Kryesore dhe aksesohen nga studentët, pedagogët, financa dhe sekretaria respektivisht sipas roleve që ato kanë në institucion dhe</p> <p>Çdo përdorues/rol ka akses të dedikuar për të dhënat që kanë lidhje me aktivitetin e tij në FSHN/USH:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Studentët kanë akses në kurrikulat e tyre, vlerësimin për kurset e frekuentuara dhe provimet, regjistrimin dhe të dhënat e orarit mësimor etj. – Personeli akademik ka akses te regjistrat e seksioneve që mbulon, procesverbalet e vlerësimit të studentëve, orarin mësimor etj. – Sekretaria mësimore ka akses të dedikuar për orarin mësimor, listat e studentëve të regjistruar në orar, të dhënat e studentëve dhe vlerësimet e tyre, të dhënat për personelin akademik të angazhuar në mësimdhënie etj. – Dega ekonomike ka akses në të dhënat e studentëve përsa i përket tarifave të studimit dhe pagesave të kryera <p>I gjithë informacioni ruhet në format hardcopy dhe elektronike në disa njësi të universitetit. Sipas rregullores së FSHN informacioni</p>

	<p>dokumentohet përmes CV, planeve mësimore, syllabuseve, ngarkesës mësimore, ngarkesën për kontribut të institucionit dhe ngarkesës intelektuale. Këto dokumenta ruhen në njësinë bazë dhe përdoren për të hartuar analizën kërkimore shkencore.</p> <p>Evidencë 22. Platforma esse 3; Evidencë 23. Platforma pitagora; Evidencë 24. Platforma smak; Evidencë 25. Platforma lms- moodle; Evidencë RVB-Perfundimtare.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit funksionon në bazë të roleve dhe të drejtave të përdoruesve të cilët pasi logohen me anë të emailit dhe fjalëkalimit kanë akses në të dhënat e tyre sipas rolit që kanë në institucion. Në këtë mënyrë administrohen të dhënat e studentëve dhe i ofrohet atyre një hapësirë vetjake/private për të aksesuar notat, ndërtuar orarin, regjistruar modulet, riprovimet etj. Në këtë mënyrë garantohet privatësia e të dhënave personale dhe liria akademike sipas legjislacionit në fuqi. Të dhënat dhe informacionet janë të kufizuara vetëm brenda aktivitetit që përdoruesit zhvillojnë në USH duke ruajtur konfidencialitetin e çdo studenti ose anëtari të personelit të FSHN. Të dhënat janë të ruajtura dhe mund të aksesohen për të gjitha vitet që përdoruesi është pjesë e FSHN.</p> <p>www.unishk.edu.al</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p> <p>Sistemi i menaxhimit të informacionit ka të integruar sistemin ESSE3 ku hidhen ruhen dhe përpunohen të dhëna në lidhje me vlerësimin e studentit. Përmes këtij sistemi studenti merr në kohë të shpejtë të dhëna në lidhje me të drejtën për të hyrë ose jo në provim, prenotimin e provimit, vlerësimin e bërë nga pedagogu gjatë semestrit, vlerësimin në provim dhe notën përfundimtare. Për të arritur një komunikim sa më të shpejtë me studentët, institucioni përdor mënyra të ndryshme si faqen web, rrjetet sociale dhe email. Kjo edhe në kuadër të mënyrave të komunikimit të përdorura nga gjeneratat e reja që janë kontigjent i studentëve në këtë program studimi.</p> <p>Evidencë 22. Platforma esse 3; Evidencë 23. Platforma pitagora; Evidencë 24. Platforma smak.</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime sipas roleve të përdoruesve në institucion. Në mënyrë automatike dhe të parametrizuar sistemi i menaxhimit gjeneron raportime në lidhje me kalueshmërinë, notën mesatare, përdormin e ambienteve didaktike, etj.</p> <p>Evidencë 22. Platforma esse 3; Evidencë 23. Platforma pitagora.</p>

Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Në faqen zyrtare të USH [https://unishk.edu.al] meret informacion në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. Në faqe gjenden informacione të detajuara në lidhje me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e USH. Përtej faqes web unishk.edu.al, USH përdor edhe rrjete sociale si Facebook, Instagram dhe LinkedIn ku publikon njoftime dhe foto të aktiviteteve, mundësi praktikash mësimore, bashkëpunime, mobilitete, etj. Kanalet e komunikimit online janë në nivel institucional dhe jo në nivel fakulteti. Ato menaxhohen në menyre të centralizuar. https://unishk.edu.al/			
Konkluzione	<i>Institucioni i arsimit të lartë disponon sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	USH harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit konform legjislacionit n harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit fuqi. Raporti financiar hartohet nga Drejtoria e Financës detajohet dhe paraqet me zërat e kostove programet e secilit cikël studimi në USH. Institucioni auditohet cdo vit nga grupi i auditimit të brendshëm. Evidencë RVB-Perfundimtare; Evidencë 4.6 Raporti financiar i kostove të programit të studimit.
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në	Mbështetja e USH për programin Bachelor në "Informatikë" është kryesisht për pagat e personelit akademik dhe ndihmës-akademik dhe administrativ. Bazuar në statutin e USH, buxheti vjetori i USH hartohet sipas njësisve shpenzuese dhe autonome sipas akteve ligjore në fuqi. Buxheti vjetor hartohet nga administratori i USH mbi bazën e propozimeve të njësisve kryesore duke u mbështetur në planin vjetor afatmesëm 2-vjeçar dhe planin strategjik të universitetit. Ai miratohet paraprakisht nga Senati akademik. Bordi i Administrimit të USH me propozim nga Senati Akademik miraton dhe mbikqur buxhetin vjetor të USH. Të ardhurat e USH vijnë si fonde nga pagesat e studentëve, të ardhura nga shërbimet e kryera, të ardhurat nga marrëdhëniet me palë të treta. Plani i financimit përmban financimin

<p>bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projekte, etj.</p> <p>Evidencë 1.Statuti ush; Evidencë 18. Analiza financiare 2022; https://unishk.edu.al/universiteti/autoritetet-dhe-organet-drejtuese/rektorati/drejtoria-e-finances-dhe-buxheti/buxheti.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Buxheti i programit të studimit bachelor në Informatikë, si program i ofruar nga një institucion publik i arsimit të lartë, i nënshtrohet auditeve të brendshme apo nga KLSH sipas legjislacionit në fuqi. Universiteti bën të njohur dhe transparente për publikun, pasqyrën e të ardhurave nga tarifat e studentëve dhe burime të tjera. Në faqen web të USH gjejmë të publikuar të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me raportimin financiar.</p> <p>https://unishk.edu.al/universiteti/autoritetet-dhe-organet-drejtuese/rektorati/drejtoria-e-finances-dhe-buxheti/buxheti Evidencë 18. Analiza financiare 2022.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>USH ndjek politika për programin e transparencës me qëllim rritjen e transparencës në USH. Në faqen web të USH ka një sesion të dedikuar për transparencën, plan-buxhetit, realizimit të buxhetit dhe pasqyrave financiare. Raporti i Analizës Financiare që institucioni e harton për periudhën afatmesme dhe afatgjatë ka për qëllim informimin e personave të autorizuar në USH për përdorimin dhe menaxhimin sa më eficient të të ardhurave dhe për ta raportuar këtë informacion deri në nivelin e njësisë bazë.</p> <p>Evidencë 18-XVIII. Analiza financiare 2022; https://unishk.edu.al/universiteti/autoritetet-dhe-organet-drejtuese/rektorati/drejtoria-e-finances-dhe-buxheti/buxheti.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Dega e Financës dhe Buxhetit ndjek zbatimin e të gjitha procedurave financiare të lidhura me planifikimin dhe realizimin e buxhetit në USH-së. USH rezulton se ka kapacitete të mjaftueshme financiare (kryesisht financimin nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat nga studentët për të realizuar objektivat e tij. Numri i studentëve të rregjistruar për herë të parë në këtë program studimi paraqet qëndrueshmëri në tre vitet e fundit (rreth 45 studentë/vit), duke kontribuar edhe nëpërmjet tarifave për dhe gjatë shkollimit. Sipas analizës financiare të institucionit, për vitet 2023-2025 prashikohet rritje e të grantit (fonde të pakushtëzuara) me 3%.</p> <p><i><u>GVJ rekomandon që USH të shtojë angazhimin dhe aplikimet për projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat përveç se mbështetjes e përmirësimit e cilësisë në mësimdhënie dhe</u></i></p>

	<p><u>mësimnxënie në programin e studimit, do të ndihmonin në diversifikimin e të ardhurave financiare të programit të studimit.</u></p> <p>Evidence 4.6-Raporti financiar i kostove të programit të studimit; Evidencë 27. Kuotat e projekt buxhetit 2019-2021; Evidencë 18. Analiza financiare 2022.</p>			
Konkluzione	<p>- <u>USH rezulton se ka kapacitete të mjaftueshme financiare (kryesisht financimin nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat nga studentët për të realizuar objektivat e tij. Numri i studentëve të rregjistruar për herë të parë në këtë program studimi paraqet qëndrueshmëri në tre vitet e fundit (rreth 45 studentë/vit), duke kontribuar edhe nëpërmjet tarifave për dhe gjatë shkollimit.</u></p> <p>- <u>GVJ rekomandon që USH të shtojë angazhimin dhe aplikimet për projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat përveç se mbështetjes në përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie në programin e studimit, do të ndihmonin në diversifikimin e të ardhurave financiare të programit të studimit.</u></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Nga dokumentacioni që i është vënë në dispozicion GVJ, konstatohet se institucioni ka të përcaktuara procedurat që duhet të ndiqen për pranimin e studentëve në programin Bachelor në Informatikë. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve të programit të studimit. Në aktet rregullatore: Statuti i USH-së, Rregullorja e Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Rregullorja e programit Bachelor në Informatikë përshkruhet procesi i regjistrimit të studentëve, i zhvillimit të procesit mësimor, i transferimit të studimeve, njohjes dhe njehsimit të diplomave, procedura e ankimimit dhe diplomimit të tyre.</p> <p>GVJ gjen hartimin e dokumenteve bazë institucionale në përputhje me Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe zbatimit të udhëzimeve të MASR nr.10 datë 15.05.2019, nr.17 datë 30.07.2019.</p> <p>Evidencë 1. Statuti USH; Evidencë 1.6 Rregullore e FSHN; Evidencë 2.9 Rregullore studimesh Informatike.</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton zbatimin e procedurave që garantojnë barazinë në çdo student. Procedura dhe kriteret specifike bëhen publike sipas akteve rregullatore të hartuara nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe të miratuara në njësinë bazë, atë kryesore dhe në Senatën Akademik të USH. Rregullorja e FSHN përmban procedurat dhe praktikën e trajtimit të studentëve që nga momenti i regjistrimit deri në përfundim të studimeve gjë që garanton procedura transparente dhe trajtim të barabartë të të gjithë kandidatëve. Dokumentet institucionale përcaktojnë qartë të drejtat dhe detyrimet për stafin mësimor dhe studentët duke mos cënuar lirinë përkatëse të tyre.</p> <p>Evidencë 1 statuti USH; Evidencë 5.1 Kriteret e pranimit në programin e studimit BA.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim</p>	<p>Departamenti i Matematikës propozon për çdo vit akademik kriteret e pranimit të studentëve në programin mësimor, miratimi i të cilës bëhet nga Fakulteti dhe Senati Akademik dhe vijon me MASR. Kriteret pranuese, kërkesat e veçanta dhe afatet e regjistrimeve bëhen publike në faqen zyrtare të USH si edhe në portalin U-Albania. Për çdo vit akademik, për kuotat e programit Bachelor në Informatikë parashikohen kuota të veçanta për studentë të huaj, nga trojet, me statusin e jetimit, me aftësi të kufizuara dhe nga komunitetet Romë dhe</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 48

<p>të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Egjiptiane. GVJ konstaton se procedurat e hartimit dhe miratimit të kriterëve specifike për pranimin e studentëve në këtë program studimi është e mirëpërcaktuar në aktet rregullatore institucionale të USH.</p> <p>Evidencë 1. Statuti USH; Evidencë 1.6 Rregullore e FSHN; Evidencë 5.1-Kriteret e pranimit në programin e studimit BA; Evidencë 5.5-Informacion për kuotat e pranimit për trojet, pakicat.</p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik, GVJ konstatoi se FSHN ju vë në dispozicion informacion të plotë në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Ky informacion është qartësisht i shprehur në rregulloret e institucionit. Për sa i përket kriterëve dhe procedurave të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, ato janë të shprehura në rregulloren e IAL dhe rregulloren e njësisë kryesore.</p> <p>Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë të qarta dhe të mirëpërcaktuara në rregulloret e institucionit. Gjithashtu, këto rregullore edhe pse janë në dispozicion të të gjithë të interesuarve brenda institucionit, përfshirë sekretarinë mësimore, dekanatin dhe njësinë bazë, <u>ato nuk janë publike dhe të aksesueshme në faqen zyrtare online të USH.</u></p> <p><u>GVJ sugjeron bërjen publike online të rregulloreve institucionale në faqen zyrtare të IAL në mënyrë që të jenë më lehtë të aksesueshme nga të gjithë të interesuarit, dhe jo vetëm studentët e këtij institucioni.</u></p> <p>Evidencë 1.6 Rregullore e FSHN; Evidencë 2.9 Rregullore studimesh Informatike.</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Kandidatët për studentë dhe gjithë të interesuarit kanë disa mundësi alternative për të marrë informacion rreth programeve të studimit të ofruara dhe mundësive që ofrohen në USH. USH në mënyrë periodike merr pjesë në Panairin e Arsimit, Edukimit dhe Punës “Work and Study” dhe prezanton programet e studimit që ofron së bashku me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta. Në këto takime informimi USH paraqitet me material promovues të përgjithshëm si: guida për studentët e rinj dhe material të vecante në lidhje me programet e studimit sic është programi Bachelor në Informatikë. Gjithashtu, studentët e ardhshëm mund të informohen edhe gjatë diteve të hapura që organizohen nga zyra e Karrierës cdo fillim viti akademik, faqes online të universitetit dhe rrjeteve sociale.</p> <p><u>GVJ sugjeron pasurimin e faqes zyrtare, konkretisht të rubrikës Studime në UNISHK dhe rubrikës Studentët.</u></p> <p>Evidencë 13. Guida per studentet. Evidencë 1.2 Fletëpalosja për Panairin Work & Study; Evidencë 42. Raport nga zyra e këshillimit të karrierës dhe alumnit.</p>

<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Për cdo vit akademik, në kuotat e programit Bachelor në Informatikë parashikohen edhe kuota të veçanta për aplikantë nga trojet, ata me statusin e jetimit, me aftësi të kufizuara dhe nga komunitetet Rome dhe Egjiptiane. Kriteret përzgjedhëse janë të njëjta si për kandidatët e tjerë por kuotat janë të dedikuara dhe aplikimet bëhen sipas udhëzimeve të ministrisë përgjigjëse për arsimin e lartë. Kriteret pranuese, kërkesat e veçanta dhe afatet e regjistrimeve publikohen në faqen zyrtare të USH, në rrjetet sociale, si edhe në portalin U-Albania.</p> <p>Evidencë 5.5 Informacion për kuotat e pranimit për trojet, pakicat; Evidencë 1.6-Rregullore e FSHN.</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Për cdo vit akademik, në kuotat e programit Bachelor në Informatikë parashikohen edhe kuota të veçanta për aplikantë të huaj. Në kuotat e parashikuara për vitin akademik 2023-2024 programi Bachelor në Informatikë kishtë parashikuar 7 kuota për kandidatë nga trojet por nuk parashikon kuota për shtetas të huaj sepse programi i studimit ofrohet në gjuhën shqipe. Kriteret përzgjedhëse janë të njëjta si për kandidatët e tjerë por kuotat janë të dedikuara dhe aplikimet bëhen sipas udhëzimeve të ministrisë përgjigjëse për arsimin e lartë. Kriteret pranuese, kërkesat e veçanta dhe afatet e regjistrimeve publikohen në faqen zyrtare të USH, në rrjetet sociale të FSHN si edhe në portalin U-Albania.</p> <p>Evidencë 5.5 Informacion për kuotat e pranimit për trojet, pakicat: https://unishk.edu.al/njoftime.</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>USH aplikon politikat shtetërore për bursat studentore për shtresat në nevojë dhe për studentët me rezultate të larta akademike.</p>
<p>Konkluzione</p>	<ul style="list-style-type: none"> - <i>USH harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e brendshme institucionale.</i> - <i>Fakulteti i Shkencave të Natyrës, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</i> - <i><u>GVJ sugjeron përditësimin e faqes zyrtare të USH dhe plotësimin edhe me një sesion Legjislacioni, ku të ngarkohen të gjithë rregulloret dhe udhëzuesit institucionale në lidhje me programet e studimit.</u></i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik, GVJ konstatoi se FSHN vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Përgjegjesi i departamentit dhe çdo staf akademik të angazhur në këtë program i informon studentët për kriteret e përparimit akademik për lëndët që ai mbulon. Informacion në lidhje me përparimin akademik të studentëve gjendet edhe në rregulloret e institucionit.</p> <p>GVJ gjeti pasqyrimin e akteve rregullore për kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve në Kreu V- Kontrolli i Dijeve të rregullores së USH-së.</p> <p>Evidencë 1.6-Rregullore e FSHN; 2-II. Rregullore e studimeve në USH; Evidencë 2.9 Rregullore studimesh Informatike.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>USH ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve për të gjithë ata që gëzojnë statusin e studentit, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda tij, apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë. Transferimet lejohen në të njëjtin cikël studimi e në fusha studimi të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik. Studentët informohen në lidhje me procesin mësimor edhe përmes sekretarisë mësimore duke u njoftuar për lëndët, regjistrimin përkatës, grupet dhe rezultatet e provimeve.</p> <p>GVJ gjeti pasqyrimin e akteve rregullore për transferimet, njohjen e krediteve dhe ekuivalentimi e lëndëve në Nenin 20, 21 të rregullores së USH-së dhe në rregulloren e FSHN-së, Neni 31.</p> <p>Evidencë 1.6 Rregullore e FSHN; Evidencë 2. Rregullore e studimeve në USH; Evidencë 3.2 Vendim_218.1_date_22.01.2020 për ndryshime në rregullore.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Në fillim të vitit akademik studentët informohen me komunikim të drejtpërdrejt në auditor nga drejtuesit e departamenteve të cilët mbajnë kontakte të vazhdueshme përgjatë vitit akademik me studentët. Informacioni hard-copy (guida, rregullore të posacme, fletëpalosje, procedura, etj.) është në dispozicion të studentëve në ambientet e sekretarisë mësimore në FSHN.</p>

	<p>Gjatë vizitës së kryer, GVJ konstatoi që studentët ishin të mirë informuar në lidhje me mënyrën e vlerësimit të dijeve. Në fillim të çdo lënde apo moduli pedagogu përkatës i prezanton studentëve planin mësimor të lëndës së tij dhe rregullat e avancimit akademik. Vlerësimi i dijeve është i përcaktuar në syllabuset e lëndëve dhe forma e kontrollit të dijeve është pjesë e përgjegjësisë dhe lirisë akademike të titullarit të lëndës.</p> <p>Evidencë 1.6 Rregullore e FSHN; Evidencë 2. Rregullore e studimeve në USH; Evidencë 3.6 Programet e lëndëve.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>GVJ në takimin me studentët konstatoi se ata ishin të informuar mbi procedurat e punimit të temës së diplomës dhe /ose provimit të diplomimit. Diplomimi i studentëve realizohet me provim perfundimtar ose me punim diplome. Kjo është pasqyruar në aktet rregullatore të USH dhe FSHN. Programi i miratuar i provimit përfundimtar i miratuar dhe fushat e punimit të diplomës, u behen të njohura studentëve në fillim të semestrit të parë të vitit të fundit të studimeve. Diplomimi me punim diplome mund të zgjidhet nga studentët që kanë notë mesatare më të madhe se 8.5.</p> <p>Procedura e diplomimit është e shprehur qartë në rregulloren e USH dhe rregulloren e FSHN. Drejtuesi i departamentit, stafi akademik, faqia ueb e USH dhe rrjetet sociale janë disa nga burimet e informacionit për studentët.</p> <p>Evidencë 1.6 Rregullore e FSHN- Neni 37; Evidencë 2. Rregullore e studimeve në USH - Kreu V; Evidencë 3.10 Programi i provimit të formimit_Informatika 2022 – 2023.</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>GVJ nga takimi me studentët evidentoi se ata kishin pasur disa mundësi alternative për të marrë informacion rreth programeve të studimit të ofruara dhe mundësive që ofrohen në USH, si psh: guida, ditet e hapura për maurantët, rregullore të posaçme, fletëpalosje, procedura, panairi Work and Study, guida e studentit, web site, rrjete sociale, broshura.</p> <p>https://unishk.edu.al/aktivitete; Evidencë 42. Raport nga zyra e këshillimit të karrierës dhe alumnit.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<ul style="list-style-type: none"> - FSHN sipas rregulloreve të tij dhe rregulloreve institucionale disponon informacion të plotë në lidhje me përparimin akademik të studentëve. - Drejtuesit e departamenteve kryejnë takime informuese me studentët në fillim të vitit akademik dhe më pas mbajnë kontakte dhe kryejnë takime periodike me studentet përgjatë vitit akademik. 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	GVJ konstatoi se studentët janë të informuar në lidhje me strukturën e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen dhe të gjitha aspektet e aktiviteteve akademike të lidhura me avancimin e tyre akademik. Informacionin fillestar në lidhje me procesin mësimor (kohëzgjatjen dhe strukturën e tij) studentet e marrin përmes sekretarisë mësimore në momentin e regjistrimit në programin e studimit. Ne vijim te studentët marrin informacion të përditësuar në lidhje me programin e studimit nëpërmjet sistemit Pitagora ku ato logohen me kredencialet e tyre. www.unishk.edu.al; Evidencë 23. Platforma pitagora.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Detajet në lidhje me përmbajtjen e lëndës, temat, shpërndarjen e tyre gjatë semestrit, mënyrë e vlerësimit, detyrimet akademike dhe administrative, jepen në orën e parë të mësimit nga pedagogu i lëndës në të cilën prezantohet edhe plan programi i lëndës. Studenti ka qasje të personalizuar në hapësirën e tij private të manaxhimit të ciklit akademik [Sistemi Pitagora] që nga regjistrimi në kurse, syllabusi i lëndëve, vlerësimet në secilin kurs deri në diplomim. Gjithashtu, studentit ka mundësi të informohet në lidhje me udhëzuesit, lëndët dhe veprimtaritë formuese në ambientet e sekretarisë mësimore, ndersa vendimet që lidhen me studentët të marra nga senati, bordi i administrimit, rektorati apo dekanati u komunikohet studentëve nëpërmjet takimeve të drejtpërdrejta. https://unishk.edu.al/njofitime; Evidencë 23. Platforma pitagora; Evidencë 3.6 Programet e lëndëve.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Zyra e Karrierës e cila funksionon në nivel institucional ofron në mënyrë të vazhdueshme për studentët: informacion dhe trajnim mbi situatën në tregun e punës, mundësi për zhvillimin e kompetencave, dhe lidhjen me bizneset. Për të prezantuar studentet me mundësitë e ofruara për praktika profesionale dhe punësim, Universiteti “Luigj Gurakuqi” organizon cdo vit në mjediset e universitetit Panairin e Punës. Të dhëna të përditësuara dhe njoftime përmesimi për studentët gjenden në faqen zyrtare të USH, në Zyrën e Karrierës dhe në llogarinë në facebook dhe instagram. Funksionimi i Zyrës së Karrierës është i rregulluar në nivel institucional nëpërmjet rregullores së kësaj njësie. Evidencë 7. Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës; Evidencë 42. Raport nga zyra e këshillimit të karrierës dhe alumnit/

<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Përdorimi i sistemit Pitagora u mundëson studentëve të USH-së informacion të përditësuar për të gjithë mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe ambienteve në të cilat zhvillohet mësimi.</p> <p><i>GVJ sugjeron që shërbimet në funksion të realizimit të programit mësimor (orari mësimor, infrastruktura mbështetëse, etj) dhe kontaktet me administratën, sekretarinë, dhe stafin akademik përgjegjës për programin e studimit të jenë publikuara dhe të përditësuara në faqen zyrtare të USH.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>USH përdor sistemin e brendshëm të menaxhimit në të cilin regjistrohet dhe arkivohet i gjithë informacioni i studentit që nga regjistrimi deri në diplomim. Sistemi i menaxhimit ka integruar sistemin ESSE3 në vitet 2020-2021 dhe sistemin Pitagora të RASH nga viti 2021 e në vazhdim. Në sistemin Pitagora mund të aksesohen të dhëna në lidhje me strukturën e vitit akademik, orarin mësimor, planin mësimor, syllabuset e lëndëve të cilat është lehtësisht i aksesueshëm online. GVJ konstaton se informacioni në lidhje me programin e studimit është i arritshëm lehtësisht nga studentët në distancë nëpërmjet ndërfaqes online të sistemit të menaxhimit, por nuk është i aksesueshëm online në faqen zyrtare web.</p> <p>Evidencë 23. Platforma pitagora; Evidencë 22. Platforma esse 3.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Sistemi i menaxhimit që përdor IAL dhe stafin akademik ofrojnë për studentët informacion të plotë e të hollësishëm në lidhje me objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënies dhe mundësitë e punësimit. Aksesimi i informacionit nëpërmjet sistemit të menaxhimit është i kufizuar sipas të drejtave të përdoruesve dhe studentët kanë akses pasi logohen me kredencialet e tyre në sistemin online.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron që shërbimet në funksion të realizimit të programit mësimor (orari mësimor, infrastruktura mbështetëse, etj) dhe kontaktet me administratën, sekretarinë, dhe stafin akademik përgjegjës për programin e studimit të jenë publikuara dhe të përditësuara në faqen zyrtare të USH.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.4</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe</p>	<p>USH mban të dhëna statistike vjetore për numrin e studentëve dhe të të diplomuarve. Të gjitha këto të dhëna disponohen nga sekretaria</p>




<p>mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>mësimore e FSHN-së e cila i hedh në regjistrin e diplomimeve sipas kuadrit ligjor ne fuqi dhe i përcjell ato tek drejtuesit e departamenteve dhe në zyrën e ALUMNI. Parelisht, këto të dhëna mund të aksesohen në bazë rolesh dhe të drejtash të përdoruesve edhe brenda sistemit ESSE3 dhe Pitagora.</p> <p>Evidencë 40. Rregullore e administrates ush; Evidencë 5.6 Tabela-Studentët në hyrje- dalje; Evidencë 42. Raport nga zyra e këshillimit të karrierës dhe alumnit; Evidencë 37. Organika ush.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Mbështetur në ligjin Nr. 80/2015 për arsimin e lartë, të dhënat e studentëve mbahen, administrohen, monitorohen dhe kontrollohen në sekretarinë mësimore. GVJ ndërmori një vizitë në sekretarinë mësimore e cila administron të dhënat e studentëve që nga faza e regjistrimit deri në përfundim të studimeve. Të dhënat mbahen në formë të shkruar dhe elektronike në tre regjistra: Regjistri themeltar i studentëve; Regjistri i arritjeve akademike; Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave.</p> <p>Të dhënat për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi për 3 vitet e fundit akademike paraqiten si vijon:</p> <p>Viti akademik 2020-2021 41 studentë; Viti akademik 2021-2022 48 studentë; Viti akademik 2022-2023 61 studentë;</p> <p>Nga takimi me kryesekretaren e FSHN-së, GVJ konstaton se regjistrimi i studentëve në procedurën e aplikimit dhe të pranimit është në përputhje me rregulloret institucionale dhe në përputhje me aktet ligjore të përcaktuara nga MASR. Të dhënat e plotësuara për çdo student të regjistruar janë në renditje kohore me datën e regjistrimit të studentëve. Këto të dhëna mbahen edhe në regjistrin elektronik Pitagora. Regjistri themeltar i studentëve është i plotësuar në përputhje me shtojcën Nr.2 të udhëzimit Nr.31 datë 16.09.2014 të MASR “Për pajisjen e Institucioneve të Arsimit të Lartë Publik dhe Privat me Regjistrat Bazë të Studentëve”. GVJ verifikoi edhe regjistrin e arritjeve akademike. Verifikimi u bë me të dhënat e dy studenteve të përzgjedhur në mënyrë rastësore në një procesverbal provimi me notat përkatëse të studentëve të zgjedhur të hedhur në regjistrin e arritjeve akademike. Verifikimet gjejnë një përputhje të notave dhe plotësimi i tij është në përputhje me kuadrin ligjor. Sekretaria mësimore është përgjegjëse edhe për administrimin e të dhënave të studentëve që diplomohen. Të dhënat plotësohen në regjistrin e diplomave dhe terheqja e saj me suplementin e diplomës bëhet nga vetë studenti ose përmes një autorizimi të noterizuar.</p> <p>Evidencë 2. Rregullore e studimeve në ush; Evidencë 5.6 Tabela-Studentët në hyrje- dalje.</p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes</p>	<p>Të dhënat e studentëve mbahen në Regjistrat bazë që ruhen në mënyrë të përhershme në përputhje me ligjin “Për Arkivat” dhe janë objekt kontrolli dhe në sistemin e menaxhimit të universitetit Pitagora që</p>

<p>sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>ofrohet nga RASH dhe garanton ruajtjen e konfidencialitetit dhe vërtetësinë e të dhënave. Disa nga funksionalitetet për studentët që mundëson sistemi Pitagora janë: regjistrimi në silabuset e kurseve, vlerësimet, procesverbalet e provimeve, diplomimi, transferimet ndërmjet universiteteve dhe mbartja e krediteve të fituara, etj. Sistemi Pitagora ka thjeshtuar mjaft punën si për personelin akademik ashtu dhe për sekretarinë, pasi të dhënat plotësohen elektronikisht nga pedagogu dhe aksesohen në kohë reale nga studentet në hapësirën e tyre personale brenda sistemit. Procesverbalet e detyrimeve dhe të provimeve të plotësuara elektronikisht në sistem, të printuara dhe firmosura nga pedagogu përgjegjës ruhen edhe në hard copy duke ofruar siguri të lartë. Ky sistem, lejon përpunimin e thjeshtuar dhe në kohë më të shkurtër të të dhënave. Aksesimi i të dhënave statistikore brenda sistemit Pitagora realizohet konform të drejtave dhe roleve të përdoruesve sipas rregulloreve institucionale dhe sipas organigramës së IAL-së duke ruajtur konfidencialitetin e të dhënave në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.</p> <p>Evidencë 2. Rregullore e studimeve në ush; Evidencë 1.6-Rregullore e FSHN; Evidencë 37. Organika USH; Evidencë 38. Struktura akademike.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritetë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Pranë FSHN ushtron detyrën e saj Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë e cila rregullon administrimin e punë në kuadër të vlerësimit akademik dhe vlerësimit të cilësisë, vlerësimit institucional, vlerësimit të programeve të studimit, kontrollit periodik dhe përmirësimit. Kontrolli periodik i përvitshëm për dokumentimin e saktësisë së informacionit që lidhet me studentët dhe veprimtaritë e tyre përkatëse është një procedurë e sanksionuar në rregulloren e Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë. NjBSC përbëhet nga 5 anëtarë nga të cilët një student. Bazuar në rregulloren e FSHN, në nivel njësie kryesore Dekani organizon dhe mbikqyr cilësië e mësimdhënies kerkimit shkencor, të zbatimit të kontratave të punës dhe të detyrimit tjetër të marre përsipër nga departamentet dhe fakulteti, ndesa në nivel njësie baze përgjegjësi i departamentit ushtron kontrole për realizimin dhe cilësinë e mësimdhënies e të kerkimit shkencor. Gjithashtu sekretaria mesimore mban përgjegjësi administrative për saktësinë e dokumentave të hartuara e të lëshuara që i përcillen për firmë instancave më të larta.</p> <p>Evidencë 34. Programi i transparencës; Evidencë 3.5 Rregullore e NJSBC, FSHN; Evidencë 3.4 NjBSC për USH; Evidencë 1.6 Rregullore e FSHN.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre,</p>	<p>Përgjegjësi i Departamentit harton raportin periodic të analizës mesimore ku analizohen lëndët mësimore dhe problematikat e programit të studimit. Ky raport diskutohet në mbledhje departamenti dhe i përcillet Dekanit. Zyra e Alumni merr informacion nga sekretaritetë mësimore në lidhje me studentët e diplomuar dhe i gjurmon nëpërmjet adresave të tyre elektronike dhe/ose numrave të telefonit. Zyra Alumni</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 56

duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	<p>ka analizuar përqindjen e punësimit të studentëve të USH në Bashkinë Shkodër, Drejtorinë e Shëndetit Publik dhe në Universitetin e Shkodrës. Mesatarisht 70% e të punësuarve në këto institucione janë ALUMI të USH.</p> <p>FSHN, për të përmirësuar objektivat e programit të studimit, ndjek rekomandimet e raportit të realizuar nga nga zyra e Alumnit dhe Karrierës për analizimin e të dhënave mbi punësimin e studentëve dhe studimin e kurrikulës dhe syllabuseve.</p> <p>Evidencë 5.7 Analizë mësimore shkencore; Evidencë 17. Analiza mesimore- shkencore 2022; Evidencë 42. Raport nga zyra e këshillimit të karrierës dhe alumnit Evidencë 2.15-Studimi i Tregut të Punës Informatikë</p>			
Konkluzione	<p><i>Drejtoria e Komunikimit, Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, është struktura përgjegjëse në USH që mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	<p>Bazuar në Statutin e USH-së studentët kanë të drejtë të përfaqësohen dhe të marrin pjesë në vendimarrje në të gjitha organet drejtuese të USH-së. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në Senatin Akademik të USH dhe të zgjedhurin e tyre në bordin a administrimit, si edhe janë pjesë e GVB të programeve të studimit.</p> <p>Evidencë 1. Statuti USH; Evidencë 2. Rregullore e studimeve në USH; Evidencë 2.7 Grupi. RVB 2022 – 2023.</p>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me	<p>Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në menaxhim dhe në vendimarrje. Studentët kanë përfaqësimin e tyre në Senatin akademik të USH, ku sipas statutit të USH studentët zënë 10% të anëtarëve të senatit dhe në Bordin e Administrimit. Bazuar në statutin e institucionit, Neni 18, pika 6, në përberje të komisioneve të përhershme të USH, studentët përfaqësohen me të paktën një anëtar, me përjashtim të Komisionit për Dhënie të Gradës Shkencore “Doktor” dhe Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik. IAL paraqet evidencë për përfaqësimin e studentëve në Komisionin për Garantimin e Standardeve të Cilësisë në USH. <i>GVJ vëren që në vendimin për krijimin</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 57

<p>rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p><i>e Komisionit për Garantimin e Standardeve të Cilësisë, emri i studentit është i papërcaktuar.</i></p> <p>Studentët organizohen edhe në këshilla studentorë ku paraqesin problematika në lidhje me programet e studimit, planet mësimore dhe procesin mësimor. Këshillat studentore janë organe të pavarura të IAL që promovojnë pojesëmarrjen e studentëve në organet drejtuese të USH-së. Këshilli i studentëve zgjidhet cdo dy vjet.</p> <p><u><i>Nga takimi me studentët GVJ konstatoi që studentët nuk kishin informacion në lidhje me përfaqësimin e tyre në organet vendimarrëse të institucionit. GVJ sugjeron marrjen e masave të nevojshme nga njësitë respektive në USH për informimin e vazhdueshëm mbi rëndësinë e përfaqësimit të tyre në të gjithë organet vendimarrëse të USH si dhe publikimin e këtij informacioni në faqen zyrtare të USH.</i></u></p> <p>Evidencë 1. Statuti USH;</p> <p>Evidencë 14. Vendim i sa për krijimin e ksgc;</p> <p>Evidencë 6.1 Urdhri i ngritjes së grupit NJSBC FSHN;</p> <p>Evidencë 50. Vendim për anëtarësimin në bord të perfaqësuesit të studentëve;</p> <p>Evidencë 33. Rregullore e keshillave student;</p> <p>Evidencë 32. Rregullore e zgjedhjeve studentor;</p> <p>Evidencë 31. Urdhër për fillimin e zgjedhjeve të këshillave studentorë;</p> <p>Evidencë 5.2 Emrat e studentëve përbërës në këshillin studentor;</p> <p>Evidencë Minuta takimi Bsc. Matematike dhe Bsc. Informatike.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Opinionin e studentëve vlerësohet në mënyrë të vazhdueshme dy herë në vit para sezonit të provimeve me anë të anketimeve dhe pyetësorëve që kanë për qëllim të analizojnë cilësinë e mësimdhënies për personelin akademik dhe lëndët e frekuentuara në cdo semestër mësimor. Rezultatet e pyetësorëve i përcillen përgjegjësit të njësisë bazë i cili analizon rezultatet e ankimimit dhe diskuton në departament problematikat e identifikuar për përmirësimin e tyre në të ardhmen. Rezultatet e pyetësorëve bëhen pjesë e raportit vjetor të analizës mësimore të njësisë bazë. Studentët ftohen nga organet drejtuese për të diskutuar mbi problematikat dhe rekomandime për zgjidhjen apo përmirësimin e tyre.</p> <p>Evidencë 5.3 Analizë e pyetësorëve të studentëve;</p> <p>Evidencë 2.12 Ndryshime në planin mësimor.</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Rregullorja e USH dhe Rregullorja e FSHN garantojnë të drejtën e studentit për të dhënë mendim në lidhje me procesin mësimor, stafin akademik dhe infrastrukturën. Pyetësorët semestralë mundësojnë studentin të shprehë mendimin e tij në lidhje me cilësinë e procesit mësimor. Gjetjet nga përpunimi statistikor i pyetësorëve shërbejnë si bazë për përmirësimin e programit dhe për ndërmarrjen e plan veprimt nga ana e departamenteve. Bazuar në takimin që GVJ pati me studentët, konstatohet që FSHN garanton transparencë në procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve.</p> <p>Stafi akademik i jep studentëve rezultatin e provimit brenda 7 ditëve nga realizimi i provimit dhe sqaron studentët në lidhje me vlerësimit.</p>

	<p>Pas ballafaqimit me komisionin e provimit të lëndës studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe vlerësimin. Ankesa i drejtohet me shkrim Dekanit ditën e publikimit të rezultatit. Nëse ankesa gjykohet e arsyeshme, ia percjell kërkesën departamentiti i cili ngre një komision ad-hoc për rishikimin e tezës. Bazuar në evidencat e paraqitura, IAL ka në përdorim programin CleanScore për korrigjim të automatizuar të testit por GVJ në dokumentacionin e shqyrtuar nuk gjen evidencë të përdorimit nga pedagogët të vlerësimit të njohurive dhe dijeve përmes teknologjisë dhe sugjeron IAL të nxisë përdorimin e sistemeve të tilla për rritjen e transparencës në vlerësim.</p> <p>Evidencë 5.3 Analizë e pyetësorëve të studentëve; Evidencë 3.7 Procedurë ankimore e studentëve; Evidencë 21. Projekti cleanscore.</p>			
Konkluzione	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Studentët me përfaqësuesit e tyre angazhohen në organet vendimmarrëse Senatin Akademik të USH dhe Keshillat Studentorë. Opinioni i studentëve vlerësohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit akademik nëpërmjet anketimeve dhe pyetsorëve dhe reflektohet në përshtatjen e mësimdhënies, orareve mësimore, shpërndarjes së provimeve etj.</i> - <i><u>Nga takimi me studentët GVJ konstatoi që studentët nuk kishin informacion në lidhje me përfaqësimin e tyre në organet vendimmarrëse të institucionit. GVJ sugjeron marrjen e masave të nevojshme nga njësitë respektive në USH për informimin e vazhdueshëm mbi rëndësinë e përfaqësimit të tyre në të gjithë organet vendimmarrëse të USH si dhe publikimin e këtij informacioni në faqen zyrtare të USH.</u></i> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	<p>USH ka në përbërje të tij Drejtorinë e Komunikimit, Kërkimit shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, i cili është në shërbim të informimit të studentëve. Ky sektor është përgjegjës për shërbimin e informacionit dhe komunikimit të vazhdueshëm me studentët dhe me palë të treta.</p> <p>Drejtoria e Komunikimit, Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë në USH i informon vazhdimisht studentët e FSHN me informacione për avancimin e tyre akademik dhe karrierën pas universitare.</p>

	<p>Gjatë takimit që GVJ pati me studentët dhe stafin akademik u theksuar edhe forma të tjera komunikimi Student-pedagog si grupe Teams apo Whatsup të cilat kanë rezultuar efektive dhe të shpejta.</p> <p>Informimi i studentëve sigurohet përmes përdorimit të formave si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Takimet informuese; - Panairi i punës - Faqja ueb e USH dhe rrejtet sociale Facebook dhe Instagram; - Organet drejtuese dhe Stafi akademik i cili në fillim të çdo lënde paraqet përmbajtjen e tij, format e mësimdhënies, detyrimet e studentëve dhe leksionet; - Sekretaria mësimore e cila informon studentët për tarifrat e regjistrimit, progresin e tyre, rezultatet e provimeve deri në procesin e diplomimit duke ofruar asistencë dhe informim të vazhdueshëm; - Platforma Pitagora; - Broshura, Guida e Studentit, fletëpalosje janë një formë që kanë rritur edhe informimin e publikut dhe studentëve në lidhje me programet mësimore; <p>Evidencë 23. Platforma pitagora; Evidencë 13. Guida per studentet; Evidencë 1.2 Fletëpalosja për Panairin Work & Study; Evidencë Minuta takimi Bsc. Matematike dhe Bsc. Informatike; www.unishk.edu.al.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>USH ofron asistencë, këshillim dhe ndjek progresin e studentëve përmes strukturave të ngritura të saj të cilat funksionojnë bazuar në organigramën e USH. Ndër strukturat kryesore bazë mbështetëse për studentët janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Drejtorinë e Komunikimit, Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë në USH - Sekretaria mësimore, - Zyra e finances, - Faqet ueb [www.unishk.edu.al] dhe rrejtet sociale - Ambientet e dedikuara për njoftime në fakultet - Përgjegjësi i Departamentit - Koordinatorin e Programit të studimit <p>Nga ana institucionale studentët marrin informacion në lidhje me procesin mësimor dhe programin e studimit në sekretarinë mësimore. Drejtoria e Komunikimit, Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë drejton procesin e këshillimit të karrierës, ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve, mban kontakte me të diplomuarit dhe krijon Rrejtin Alumni, krijon mundësi bashkëpunimi me kompani për mundësi praktikash dhe punësimi për studentët/alumnit, organizon aktivitete për studentët, trajnime, seminare, workshop-e, harton dhe raporton periodikisht në MAS të dhëna statistikore, zhvillon komunikimin</p>

	<p>efektiv dhe etik me studentët, alumnit, stafin dhe të tjerë. Gjithashtu, nga ana institucionale studentët marrin informacion në lidhje me procesin mësimor dhe programin e studimit në sekretarinë mësimore dhe në departament.</p> <p>Evidencë 3. Strategjia e komunikimit 2022; Evidencë 41. Rregullore e zyrës së karrierës dhe alumnit; Evidencë 2.8 Vendim për koordinatorët e programit dhe praktikën mësimore.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Drejtoria e Komunikimit, Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë realizon këshillim dhe udhëzime në lidhje me orientimin dhe zhvillimin e karrierës profesionale të studentëve në USH dhe organizon dhe koordinon aktivitetet për studentët të tilla si: trajnime, seminare, konferenca studentore, orë leksioni të hapura nga lektorë të ftuar, etj. USH mbështet zhvillimin e aftësive praktike të studentëve, me fokus në zhvillimin efikas të praktikave profesionale me ane të bashkëpunimeve me industrinë, biznesin, kompanitë dhe institucionet që mbështeten në marrëveshje të institucionalizuara.</p> <p>Evidencë 41. Rregullore e zyrës së karrierës dhe alumnit ; Evidencë 2.17 Marrëveshje kuadër - Mou University of Shkodra Luigj Gurakuqi; Evidencë 3.13 Orë e hapur AlbaNSI; Evidencë 1.7 Marrëveshje praktika IAL; Evidencë 36. Marrëveshjet e bashkëpunimit në rang universiteti.</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Specialistët e zyrës së këshillimit të karrierës mbajnë kontakte të vazhdueshme me studentë edhe pas diplomimit si informacion i nevojshëm për vlerësimin periodik të programeve të studimit të ofruara në USH. Ato synojnë përshtatje me zhvillimin ekonomik kombëtar dhe rajonal. Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit të Standarteve ka paraqitur si evidencë një pyetësor në lidhje me programin e studimit Informatikë. Nëpërmjet pyetësorit është vlerësuar programi mësimor dhe cilësia në mësimdhënie. Për sa i përket ALUMNI studimi i paraqitur si evidencë ka vlerësuar insitucionet publike në Shkodër dhe ka matur numrin e ALUMNI të punësuar në këto institucione. Nga analiza e Zyrës së Karrierës dhe ALUMNI rezulton qe shumica e të punësuarve në institucionet publike në shkodër kanë përfunduar studimet në USH.</p> <p>Evidencë 2.15 Studimi i Tregut të Punës Informatikë; Evidencë 5.3 Analizë e pyetësorëve të studentëve.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Drejtoria e Komunikimit, Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë në USH, Sekretaria mësimore, Zyra e finances, Faqja ueb dhe rrjetet sociale, ambientet e dedikuara për njoftime në fakultet, Përgjegjësi i departamentit dhe pedagogët jane disa nga njësitë e posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>USH në nivel institucional ka hartuar Strategjinë për mësimdhënie 2022-2027 e cila ka për qëllim përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie, përmirësimin e shërbimeve të ofruara, rritjen e bashkepunimit në komunitet dhe aplikimin e standardeve të larta. Në lidhje me këtë plan strategjik, USH ka paraqitur edhe një plan veprimi me objektiva të mirëpërcaktuara.</p> <p>Evidencë 4. Strategjia e mësimdhënies 2022;</p> <p>Evidencë 10. Manuali i cilësisë;</p> <p>Evidencë 15. Vendim- rregullorë e sa per ksgc;</p> <p>Evidencë 16. Paketa e instrumentave matës të cilësisë në USH;</p> <p>Evidencë 5.3 Analizë e pyetësorëve të studentëve;</p> <p>Evidencë 5.7 Analizë mësimore shkencore;</p> <p>Evidencë 17. Analiza mesimore- shkencore 2022.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Pranë USH funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) është struktura mbikëqyrëse në USH, vlerësuese, miratuese dhe garantuese e standardeve të cilësisë së institucionit dhe e programeve të studimit. Kjo njësi ndjek përmirësimin e cilësisë së USH, duke shërbyer si një garanci e shtuar për sigurimin e cilësisë sipas Manualit të Cilësisë të propozuar nga NJSBC dhe të miratuar në Senatit Akademik të USH-së. Vlerësimi i cilësisë në mësimdhënie sigurohet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetësorit të studentit i cili vlerëson cilësinë e mësimdhënies dhe performancën e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie; - Analizës vjetore për mësimdhënien të përgatitur nga përgjegjësi i departamentit në fund të vitit akademik; <p>Evidencë 10. Manuali i cilësisë;</p> <p>Evidencë 15. Vendim- rregullorë e sa per ksgc;</p> <p>Evidencë 16. Paketa e instrumentave matës të cilësisë në USH;</p> <p>Evidencë 5.3 Analizë e pyetësorëve të studentëve;</p> <p>Evidencë 5.7 Analizë mësimore shkencore.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve dhe të ankimimeve sanksionohet në rregulloren e institucionit dhe zbatohet nga strukturat përkatëse në nivel institucional, njësie kryesore dhe njësie bazë. Studentët janë të përfshirë në disa prej strukturave vendimarrëse të USH-së. Në lidhje me vlerësimin e procesit mësimor ata marrin pjesë në anketime ku shprehin mendimin e tyre përmes plotësimit të pyetësorëve. Në fund të çdo semestri, para sezonit të provimeve, studentëve u jepet një pyetësor për vlerësimin e cilësisë së</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al



Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 63




	<p>mësimdhënies për të gjithë pedagogët me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme. Mendimi i tyre degjohet edhe nga stafi akademik. Nga takimi me studentët u theksua marrja e mendimit në mënyrë të vazhdueshme gjatë semestrit në lidhje me temat e trajtuara dhe nëse ka nevojë për përmirësime.</p> <p>Evidencë 16. Paketa e instrumentave matës të cilësisë në USH; Evidencë 5.3 Analizë e pyetësorëve të studentëve.</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Komisioni për garantimin e standardeve të cilësisë sipas rregullores së funksionimit të tij parashikon takime periodike me NJSBC-të e fakulteteve, me studentët, stafin akademik dhe jo-akademik me qëllim monitorimin e punës dhe të problematikave të ndryshme.</p> <p>Rezultatet dhe analizat e pyetësoreve që zhvillohen cdo fund semestri diskutohen në mbledhje departamentit me të gjithë anëtarët e departamentit dhe analiza e rezultateve përcillet në dekanat. Në manualin e cilësisë, Neni 17 theksohet që të dhënat e vlerësimeve bëhen të njohura për stafin dhe studentët duke u publikuar në faqen zyrtare të USH, por GVJ gjatë vizitës në institucion, shqyrtimit të RVB dhe vizitës së faqes zyrtare web të USH nuk gjen të zbatuar konkretisht.</p> <p><u>GVJ sugjeron që IAL të bëjë publike në faqen e tij zyrtare raportet vjetore të IAL dhe një përmbledhje të analizës së pyetësorëve semestrale ose vjetore.</u></p> <p>Evidencë 15. Vendim- rregullorë e sa per ksgc; Evidencë 10. Manuali i cilësisë; Evidencë 5.3 Analizë e pyetësorëve të studentëve; Evidencë 5.7 Analizë mësimore shkencore; Evidencë 17. Analiza mesimore- shkencore 2022.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Në përmbushje të misionit të tij USH-FSHN promovon shembuj të praktikave më të mira, si dhe inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien, duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnimi, leksione të hapura dhe seminare me profesorë të ftuar nga universitetet e huaja.</p> <p>USH ndjek një politikë integruese dhe ndërkombëtarizuese për stafin akademik. Personeli akademik ka qenë pjesë e shkëmbimeve të mobiliteteve duke sjellë në institucion përfitime profesionale dhe duke zgjeruar rrjetin e bashkëpunimeve si rrjedhojë e këtyre mobiliteteve, numri i stafit akademik që është angazhuar në projektet e financuara nga BE (ERASMUS+) është katër (4).</p> <p>USH tregon që mbështet financiarisht pjesëmarrjen e stafit në konferenca shkencore, publikimin periodikë shkencorë duke nxitur kualifikimin e vazhdueshëm të stafit akademik. Gjatë vitit akademik 2022-2023, stafi akademik i Departamentit të Matematikës, sipas analizës mësimore shkencore ka publikuar një (1) artikull në revistë shkencore dhe 3 referime në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare.</p>

	<p><u>GVJ sugjeron përfshirjen dhe motivimin në mekanizmat aktual dhe të stafit akademik pa grada shkencore në aktivitete dhe dhe projekte të kërkimit shkencor.</u></p> <p>Evidencë shtesë Praktike per Mbeshtetje Financiare per Kerkimin Shkencor;</p> <p>Evidencë 6.6 Pjesëmarrja e stafit në projekte;</p> <p>Evidencë 5.7 Analizë mësimore shkencore.</p>			
Konkluzione	<ul style="list-style-type: none"> - <u>Vlerësimi i cilësisë në mësimdhënie në USH sigurohet nëpërmjet: pyetësorit të studentit dhe vlerësimit të përgjegjës të departamentit për çdo anëtar të stafit. Rezultatet dhe analizat e pyetësoreve i vihen në dispozicion të gjithë anëtarëve të stafit akademik, përgjegjësve të departamenteve, si dhe dekanëve dhe problematikave dhe plani i masave diskutohet deri në nivel departamenti. USH mbështet pjesëmarrjen në projekte të stafit akademik dhe mbështet financiarisht kualifikimin e vazhdueshëm të tij.</u> - <u>GVJ sugjeron që IAL të bëjë publike në faqen e tij zyrtare raportet vjetore të IAL dhe një përmbledhje të analizës së pyetësorëve semestrale ose vjetore.</u> - <u>GVJ sugjeron përfshirjen dhe motivimin në mekanizmat aktual dhe të stafit akademik pa grada shkencore në aktivitete projekte dhe kërkim shkencor.</u> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	GVJ konstaton se institucioni ka hartuar politika dhe struktura të posaçme për sigurimin e brendshëm të cilësisë në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. Në USH, janë ngritur dhe funksionojnë Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në nivel njësie kryesore dhe Komisioni për Grantimin e Standardeve të Cilësisë në nivel njësie bazë të cilët veprojnë mbi bazën e Manualit të Cilësisë. Në nivel Institucional strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë: Senati Akademik, Drejtoria e Kurrikulave, Kërkimit Shkencor dhe Cilësisë, Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, Koordinatori Institucional pranë ASCAL. Në nivel Fakulteti përgjegjës për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë: Komisioni për Grantimin e Standardeve të Cilësisë, Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program studimi, Koordinatorët e Programeve. Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë është struktura

	<p>mbikëqyrëse, vlerësuese, miratuese dhe garantuese e standardeve të cilësisë së institucionit dhe e programeve të studimit.</p> <p>Evidencë 1. Statuti USH; Evidencë 10. Manuali i cilësisë; Evidencë 15. Vendim- rregullorë e sa per ksgc; Evidencë 16. Paketa e instrumentave matës të cilësisë në USH.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është struktura mbikëqyrëse, vlerësuese, miratuese dhe garantuese e standardeve të cilësisë të institucionit dhe e programeve të studimit. Komisioni për Grantimin e Standardeve të Cilësisë në FSHN përbëhet nga 7 anëtarë me 5 përfaqësues staf akademik efektiv, një student dhe një anëtar ekspert i jashtëm. Funksionimi i këtij komisioni bazohet në rregulloren përkatëse. Në kuadër të vlerësimit të brendshëm, GVJ konstaton se, GVB është ngritur në përputhje me Statutin e USH në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe ka hartuar Raportin e Vetvlerësimit në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore, dhe të bazuar në dokumentat që i janë vënë në dispozicion GVJ.</p> <p>Evidencë 10. Manuali i cilësisë; Evidencë 15. Vendim- rregullorë e sa per ksgc; Evidencë 6.3 Vendim për ristrukturimin e NJSBC-së në FSHN.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Sipas Vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 03, datë 24.01.2020 akreditohet periodikisht Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, me kohëzgjatjen prej 4 (katër) vite. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të Institucionit është 23/01/2024. Programi i studimit Bachelor në Informatikë është hapur me Shkrese Nr. 2517/1, datë 19.7.2002 “Mbi hapjen e kursit të ri të studimit Informaticien”, në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi". Vlerësimi i jashtëm i programit të studimit Bachelor në Informatikë, me qëllim akreditimin e programit, po realizohet për herë të parë nga ASCAL.</p> <p>Evidencë 19. Rvb institucionale 2022.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>NJSBC së bashku me Komisionin për Grantimin e Standardeve të Cilësisë ka në kompetencat e tij hartimin e raportit vjetor të sigurimit të cilësisë i cili përcillet në Senatin akademik të USH. Raporti përmban informacion të diskutuar paraprakisht me të gjithë anëtarët e departamenteve, përfaqësuesit e studentëve, të ekspertëve të jashtëm, sekretarisë mësimore dhe Dekanit. Dekani i Fakulteti aktivizon komisionin ad-hoc për rishikimin e programeve të studimit bazuar edhe në sugjerimet e departamenteve. Bazuar në instrumentat e brendshëm të saj për sigurimin e cilësisë, USH përcakton direktivat e zhvillimit, objektivat dhe fushat e përmirësimit dhe proceset kryesore të sigurimit të cilësisë. Ky proces i brendshëm i cilësisë përbëhet nga një procedurë ku zhvillohen aktivitete të rregullta monitoruese dhe përmirësuese. Rezultatet e vlerësimit, të cilat evidentojnë arritjet në procesin mësimor dhe kërkimor e shkencor dhe problematikat, diskutohen me palët përkatëse dhe në bazë të tyre nxirren rekomandimet që kanë si qëllim</p>

	<p>të adresojnë problematikat dhe mënyrat e zgjidhjes së tyre. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe në takimet me stafin akademik, GVB dhe me perfaqësues nga Drejtoria e Sigurimit të Cilësisë, GVJ gjykon që FSHN ka identifikuar tregues të qartë dhe të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim për monitorimin e standarteve të cilësisë.</p> <p>Evidencë 19. Rvb institucionale 2022; Evidencë 10. Manuali i cilësisë; Evidencë 15. Vendim- rregullore e sa per ksgc; Evidencë 16. Paketa e instrumentave matës të cilësisë në USH; Evidence 5.3 Analizë e pyetësorëve të studentëve; Evidencë 5.7 Analizë mësimore shkencore; Evidencë 17. Analiza mesimore- shkencore 2022.</p>			
Konkluzione	<p><i>Për sigurimin e brendshëm të cilësisë, USH ka ngritur struktura institucionale dhe struktura ne nivel fakulteti. Prane FSHN funksionon Komisioni për Grantimin e Standardeve të Cilësisë dhe Grupi i Vlerësimit të Brendshëm të cilat funksionojnë sipas rregulloreve të brendshme institucionale.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura</p>	<p>USH përdor mekanizma të ndryshëm për mbikëqyrjen periodike të programeve te studimit Bachelor. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë kryen në mënyrë periodike vlerësimin e programit të studimit. Pyetësorët e ndërtuar kanë për qëllim vlerësimin e cilësisë në mësimdhënie dhe vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të institucionit. Rezultatet e pyetësorëve përpunohen në mënyrë statistikore dhe shërbejnë si bazë të dhënash edhe nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm në hartimin e raportit në kuadër të akreditimit të programeve të studimit.</p> <p>Zyra e Alumnit dhe Karrierës harton pyetësorë që targetojnë kompanitë dhe alumni dhe ka për qëllim të paraqesë statistikat në lidhje me ngarkesën mësimore të stafit akademik të brendshëm dhe të jashtëm, numrin e studentëve të rregjistruar, numrin e studentëve të çrregjistruar, numrin e studentëve të diplomuar me, personelin akademik dhe administrativ, numrin e studentëve që përfitojnë bursë. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse të cilët në varësi të problematikave marrin masa për përmirësimin e treguesve.</p>

<p>autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Gjithashtu, edhe fakultetet bëjnë përpjekje për të monitoruar programet e studimit që ofrohen. Përveç analizës mësimore të punës vjetore, në një mbledhje të vecantë në departament, në fillim të vitit akademik miratohen syllabuset e lëndëve duke diskutuar dhe argumentuar ndryshimet.</p> <p>Evidencë 4. Strategjia e mësimdhënies 2022; Evidencë 17. Analiza mesimore- shkencore 2022; Evidencë 5.7 Analizë mësimore shkencore; Evidencë Vendim departamenti.</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Raportet e vlerësimit të miratuara, përcillen për diskutim në të gjitha strukturat e IAL deri në nivel njësie bazë. Ky proces finalizohet me një sërë masash në funksion të përmirësimit të programeve të studimit dhe cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p>Evidencë 19. Rvb institucionale 2022; Evidencë 10. Manuali i cilësisë; Evidencë 16. Paketa e instrumentave matës të cilësisë në USH: Evidencë 5.3 Analizë e pyetësorëve të studentëve; Evidencë 5.7 Analizë mësimore shkencore; Evidencë 17. Analiza mesimore- shkencore 2022.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>USH përdor metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e programit të studimit Bachelor në “Informatikë”. Në strategjinë e mësimdhënies të USH 2022-2026, përcaktohen prioritet kryesore si: përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe shërbimeve për studentët, vlerësimi i programeve të studimit, përmirësimi i infrastrukturës dhe ndërkombëtarizimi.</p> <p>Në planin e veprimit, për përmbushjen e objektivave të strategjisë së mësimdhënies janë të angazhuar të gjitha aktorët e IAL, si Rektorati, Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Dekanati, Përgjegjësit e Departamenteve, Pedagogët, Zyra e Ekselencës dhe Njësitë e Sigurimit të Cilësisë.</p> <p>Cilësia e mësimdhënies dhe kurrikulës kontrollohet dhe monitorohet nga Drejtuesi i Departamentit i cili mbikqyr respektimin e programeve të mësimdhënies, paraqitjen dhe disiplinën në punë dhe realizon analizat vjetore mësimore shkencore të Departamentit. Në vazhdim të gjitha strukturat e tjera marrin pjesë hastimin e masave dhe përmirësimin cilësor të mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p>Evidencë 4. Strategjia e mësimdhënies 2022; Evidencë 5. Strategjia e kërkimit shkencor 2022; Evidencë 6. Strategjia e ndërkombëtarizimit 2022; Evidencë 7. Strategjia e tregut të punës 2022.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e</p>	<p>Zyra e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional mbështetur nga njësitë kryesore në IAL, përdor metoda e instrumente të tërthorta</p>

<p>cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>vlerësimi të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimi si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - organizon pyetësore drejtuar studenteve për të marrë mendim në lidhje me cilësinë e programit të studimit dhe pedagogut përkatës dhe vlefshmërinë e tij tek ALUMNI - mbledh të dhëna në formë elektronike nga punëdhënësit kryesorë në rajon në lidhje me ALUMNI-t e USH. - organizon workshop-ve/panaire pune ku mbledh të dhëna në formë elektronike nga punëdhënësit kryesorë për mbështetjen e praktikave profesionale. <p>Gjithashtu, institucioni vlerëson edhe angazhimin administrativ dhe kërkimor shkencor të stafit akademik dhe të studentëve.</p> <p>Evidencë 5.3 Analizë e pyetësorëve të studentëve; Evidencë 5.7 Analizë mësimore shkencore; Evidencë 17. Analiza mesimore- shkencore 2022; Evidencë 6.4 Formular për vlerësimin e pedagogut; Evidencë 10. Manuali i cilësisë; Evidencë 16. Paketa e instrumentave matës të cilësisë në USH.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<ul style="list-style-type: none"> - IAL monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit. - GVJ vlerëson pozitivisht punën e Zyrës së Sigurimit të Cilësisë në përgatitjen e raporteve të vlerësimit dhe rekomandimeve të bëra. <u>GVJ sugjeron që kjo njësi të bashkëpunojë me strukturat akademike të institucionit për përgatitjen e një plani masash veprimi për adresimin e problematikave dhe ndjekjen e shkallës së përmbushjes së tyre.</u> 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Standardi VI.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentet bazë institucionale (Statuti dhe Rregullorja e USH, Kodi i Etikës dhe Rregullore e Njesise se Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë) dhe vizitat në institucion konstaton që në institucion funksionon sistemi i vlerësimit të brendshëm ku përfshihen aktorë në nivel Institucional (Senati Akademik, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Drejtoria e Komunikimit, Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë me Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni), në nivel Fakulteti (Njësia e</p>

<p>cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve, Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program, Koordinatorët e Programeve të studimit) dhe studentët. GVJ konstaton që institucioni parashikon dhe garanton përfshirjen në vlerësimin e brendshëm të aktorëve të brendshëm stafit akademik, stafit joakademik, studentët dhe grupet e interesit të lidhura me programin e studimit apo institucionit.</p> <p>Evidencë 1. Statuti USH; Evidencë 1.6 Rregullore e FSHN; Evidencë 3.5 Rregullore e NJSBC, FSHN; Evidencë 2.8 Vendim për koordinatorët e programit dhe praktikën mësimore; Evidencë 12. Kodi i etikës së USH; Evidencë 42. Raport nga zyra e këshillimit të karrierës dhe alumnit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe nga takimet e kryera në institucion, GVJ konstaton se strukturat e brendshme përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në institucion kanë detyra të përcaktuara qartë në aktet rregullatore të brendshme. Në nivel Institucional strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Senati Akademik, - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, - Koordinatori Institucional pranë ASCAL, - Drejtoria e Komunikimit, Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë me Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni <p>Në nivel Fakulteti përgjegjës për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve, - Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program studimi, - Koordinatorët e Programeve të Studimit. <p>Studentët dhe Ekspertë të jashtëm janë gjithashtu palë të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Evidencë 1. Statuti USH; Evidencë 1.6 Rregullore e FSHN; Evidencë 3.5 Rregullore e NJSBC, FSHN; Evidencë 2.8 Vendim për koordinatorët e programit dhe praktikën mësimore.</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të</p>	<p>Stafi akademik dhe administrativ bashkëpunon në mënyrë të vazhdueshme me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për cilësinë e programit të studimit, kërkimin shkencor dhe vlerësimin e brendshëm institucional. GVJ konstaton në bazë të dokumentave të shqyrtuara se, në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit Bachelor në "Informatikë" janë përfshirë staf akademik, ekspert të jashtëm dhe studentë.</p>

<p>personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>Evidencë 2.7 Grupi. RVB 2022 – 2023; Evidencë 6.3 Vendim për ristrukturimin e NJSBC-së në FSHN.</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton në bazë të dokumentave të shqyrtuara se në ngritjen e grupeve të vlerësimit të brendshëm, stafi akademik është i përfaqësuar në mënyrë jo diskriminuese si në bazë gjinie, ashtu edhe gradë apo kualifikimi akademik. Procesi i vlerësimit është gjithëpërfshirës duke respektuar elementin e barazisë dhe integritetin e stafit akademik dhe studentëve. Ky proces përfshin procesin e vlerësimit të pedagogut nga eprorët dhe nga studentët.</p> <p>Gjithashtu, në hartimin e raporteve dhe në interpretimin e të dhënave institucioni bazohet në rregulloren institucionale të sigurimit të cilësisë.</p> <p>Evidencë 2.7 Grupi. RVB 2022 – 2023; Evidencë 6.3 Vendim për ristrukturimin e NJSBC-së në FSHN Evidencë 3.5 Rregullore e NJSBC, FSHN; Evidencë 12. Kodi i etikës së USH; Evidencë 5.3 Analizë e pyetësorëve të studentëve; Evidencë 5.7 Analizë mësimore shkencore; Evidencë 17. Analiza mesimore- shkencore 2022; Evidencë 6.4 Formular për vlerësimin e pedagogut.</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>GVJ vlerëson pozitivisht institucionin që në vlerësimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë, si pjesë integruese e vlerësimit, përfshin edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm.</p> <p>Forma të tjera bashkëpunimi me aktorë të jashtëm të tregut për të marrë ekspertizë e mendime në lidhje me cilësinë e programeve të studimit dhe përmirësimin e tyre janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimi i workshopeve dhe praktikave mësimore pranë kompanive partnere; - Analiza e përputhshmërisë së planit mësimor dhe syllabuseve përkatëse me ato të ofruar në IAL të ngjashme brenda e jashtë vendit; - Mbështetja e Mobiliteteve të studentëve nëpërmjet projekteve Erasmus+. <p>GVJ vlerëson se njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Informatikë realizon një vlerësim objektiv të programit të studimit dhe nevojave për rishikimin e tij.</p> <p>Evidencë 36. Marrëveshjet e bashkëpunimit në rang universiteti; Evidencë 1.7 Marrëveshje praktika AL; Evidencë 3.13 Orë e hapur AlbaNSI; Evidencë 2.15 Studimi i Tregut të Punës Informatikë.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>USH/FSHN përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ konstaton së dokumentat (Statuti i USH dhe Planet Strategjike 2022-2027, Rregullorja e USH dhe e FSHN) në të cilat janë përshkruar politikat, strategjitë dhe veprimtaritë në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për këtë program studimi, janë vëne në dispozicion të GVJ, por konstatohet që ato nuk janë të publike në faqen web institucionale. Procesi i vlerësimit të cilësisë së programit të studimit (shpërndarja e pyetësorëve, përpunimi i tyre, marrja e rezultateve) është transparent dhe u komunikohen individualisht studenteve dhe të gjithë aktorëve të IAL-së. https://unishk.edu.al/
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	GVJ bazuar edhe në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni, dhe në takimet e zhvilluara vëren që procesi i vlerësimit të cilësisë në programin e studimit karakterizohet nga transparenca dhe ruajtja e konfidencialitetit. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucional, harton në mënyrë periodike raporte të vlerësimit të brendshëm të cilat ruhen në arkivën institucionale në përputhje me normat e ligjit nr. 9154, date 06.11.2003 "Për arkivat" me normat tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, në Rregulloren e Njehsuar të punës me dokumentet në autoritetet publike në Republikën e Shqipërisë si dhe në përputhje me politikat e brendshme të privatesisë së të dhënave i cili është hartuar në përputhje me Programin Kombëtar të Transparencës. Të gjitha të dhënat në USH përpunohen dhe bëhen publike duke zbatuar politikat institucionale të privatesisë së të dhënave personale. Rezultatet e vlerësimeve u vihen në dispozicion individualisht anëtarëve të stafit akademik të vlerësuar, përgjegjësive të departamenteve dhe dekanëve përkatës. Evidencë 34. Programi i transparencës; Evidencë 35. Politikat e privatesise.
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucional, harton në mënyrë periodike raporte në funksion të vlerësimit dhe përmirësimit të cilësisë si për program studimi ashtu edhe në nivel institucional. Rezultatet e vlerësimit, të cilat evidentojnë arritjet në procesin mësimor dhe kërkimor e shkencor dhe problematikat, diskutohen me palët përkatëse dhe në bazë të tyre nxirren rekomandimet që kanë si qëllim të adresojnë problematikat dhe

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 72

	<p>mënyrat e zgjidhjes së tyre. Për përmirësimin e planit mesimor, përpara fillimit të vitit akademik pasardhës, departamenti propozon ndryshimet e nevojshme në programin e studimit apo në elementët përbërës të tij nisur nga nevojat e identifikuar për përmirësim. Në rast se nga njëjësia bazë, konstatohet nevoja për ndryshime në kredite në masën mbi 20% të përmbajtjes së programit të studimit të akredituar, ndryshimet e hartuara nga departamenti shqyrtohen në Dekanat, miratohen në Senatin Akademik dhe i dërgohen për miratim ministrit përgjegjës për arsimin. Ndërsa, ndryshimet deri në masën 20 për qind, IAL mund t'i reflektojë në diplomën e lëshuar me miratim nga Senati Akademik i USH.</p> <p>Evidencë 1. Statuti ush; Evidencë 2. Rregullore e studimeve në USH.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Njëjësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në FSHN është riorganizuar në 25.05.2023 dhe ka në përbërjen e saj një staf akademik të konsoliduar dhe perfaqësues nga studentët. GVJ konstaton angazhim nga ana e USH në lidhje me procesin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë në programin e studimit.</p> <p>Evidencë 3.5 Rregullore e NJSBC, FSHN; Evidencë 6.3 Vendim për ristrukturimin e NJSBC-së në FSHN; Evidencë 2.8 Vendim për koordinatorët e programit dhe praktikën mësimore.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>USH mbështet të gjitha organet e brendshme në trajnime me qëllim sigurimin e cilësisë dhe rritjen e kapaciteteve njerezore dhe shërbimeve të ofruara nga institucioni. Bazuar në statutin e USH dhe rregulloren institucionale, FSHN ka caktuar një Koordinator për cdo program studimi i cili është pjesë e grupit të punës për përmirësimin e kurrikulës. Ai ndjek ecurinë e studentëve dhe trajton problematikat e tyre gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve dhe informon në mënyrë të vazhdueshme drejtuesin e njësisë kryesore / bazë në lidhje me ecurinë e programit të studimit.</p> <p>Evidencë 2.8 Vendim për koordinatorët e programit dhe praktikën mësimore.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni paraqet Kulturë të Brendshme të Cilësisë mbi politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të cilat janë të sanksionuara në rregulloret dhe strategjitë e institucionit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X
<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të Parë Bachelor në “Informatikë” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Mjediset e përshtatshme dhe infrastruktura didaktike në mbështetje të programit të studimit ofrojnë kushtet e nevojshme për zhvillimin e procesin mësimor;
2. Programi i studimit është hartuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit të Universitetit të Shkodrës dhe të zhvillimit ekonomik të vendit dhe plotëson nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;
3. Departamenti i Matematikës angazhon në këtë program studimi personeli akademik të ri në moshë dhe të përkushtuar në përçimin e dijeve në fushën e informatikës dhe shkencave kompjuterike;
4. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje të shumta bashkëpunimi në drejtim të bashkëpunimit akademik dhe profesional me IAL të tjera brenda dhe jashtë vendit;
5. Biblioteka u përgjigjet nevojave të programeve të studimit me staf të kualifikuar, ambiente infrastrukturore moderne dhe fond fizik dhe elektronik.
6. Institucioni i arsimit të lartë disponon sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.
7. Institucioni aplikon politikat shtetërore për bursat studentore për studentët në nevojë, si dhe për studentët me rezultate të larta akademike.

Pika të dobëta:

1. Ndarja e elementëve të programit të studimit nuk është përcaktuar plotësisht në përputhje me VKM.41 datë 24.01.2018, e ndryshuar, përkatësisht komponenti mësimor për lëndët ndërdisiplinore ka një shmangje të vogël nga maksimumi 15 % e lejuar është 15.6 % (**Standardi II.1/Kriteri 1**). Programet lëndore (syllabus-et) të programit të studimit nuk përmbajnë të gjithë elementët sipas përcaktimeve të VKM.41 datë 24.01.2018, e ndryshuar (**Standardi II.3/Kriteri 4 dhe Standardi IV.1 Kriteri 1**).
2. Institucioni nuk ka procedurë të miratuar për planifikimin e buxhetit për pasurimin e literaturës dhe fondit të bibliotekës me botime të viteve të fundit në funksion të ndryshimeve shumë të shpejta teknologjike në disiplinën e shkencave kompjuterike. (**Standarti IV.3, Kriteri 2**).
3. Aktualisht nuk ka projekte aktive në këtë program studimi. Institucioni nuk ka realizuar leksione të hapura, trajnime apo seminare informuese të mjaftueshme për studentët e këtij programi studimi. (**Standardi III.4/Kriteri 4 dhe 5 dhe Standarti IV.5, Kriteri 5**).

Rekomandime:

1. Institucioni të bëjë ndarjen e elementëve të programit të studimit në përputhje me VKM.41 datë 24.01.2018, e ndryshuar;
2. Institucioni të plotësojë programet lëndore (syllabus-et) të programit të studimit me të gjithë elementët sipas përcaktimeve të VKM.41 datë 24.01.2018, e ndryshuar, në rastet e munguara dhe të titullarit të lëndës me gradën/titullin e kërkuar sipas legjislacionit në fuqi, si dhe të përcaktojë temat e seminareve, ushtrimeve, punëve laboratorike, si dhe detyrave/projekteve të kursit;
3. Institucioni të angazhohet në përcaktimin e procedurës për pasurimin e literaturës së programit të studimit, në aktet rregullatore të IAL dhe njoftimin e personelit akademik dhe administrativ të përfshirë.
4. Institucioni të angazhohet për realizimin në mënyrë periodike të studimit të tregut të punës për programin e studimit dhe mbi bazën e gjetjeve të reflektojë ndryshime në programin e studimit.
5. Institucioni të angazhohet në përfshirjen dhe motivimin në mekanizmat aktual dhe të stafit akademik pa grada shkencore në aktivitete dhe projekte të kërkimit shkencor.
6. Institucioni të shtojë angazhimin dhe aplikimet për projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat përveç se mbështetjes në përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie në programin e studimit, do të ndihmonin në diversifikimin e të ardhurave financiare të programit të studimit.
7. Institucioni të angazhohet në diversifikimin e bashkëpunimeve me kompanitë në vend dhe jashtë për të mbështetur zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve.
8. Institucioni të bëjë publike online, rregulloret institucionale, raportet vjetore të IAL dhe një përmbledhje të analizës së pyetësorëve semestrale ose vjetore, në faqen zyrtare të IAL si dhe të pasurojë faqen zyrtare të institucionit me rubrikat e munguara dhe në mënyrë të vazhdueshme.
9. Institucioni të angazhohet në marrjen e masave të nevojshme nga njësitë respektive për informimin e vazhdueshëm të studentëve mbi rëndësinë e përfaqësimit të tyre në të gjithë organet vendimmarrëse të USH.



Conclusions of the Evaluation of the first cycle study program “Bachelor in “Informatics” of Higher Education Institution “University “Luigj Gurakuqi”, Shkodër

Strong points and affirmations:

1. Appropriate infrastructural and didactic facilities support the requirements of Computer Science courses offered by the Department of Mathematics in the University of Shkodra.
2. The study program is designed in accordance with the development strategy of Shkodra University and the economic development of the country and meets the needs of the labor market in accordance with the strategic goals of national economic development;
3. The Department of Mathematics organises the study program with the commitment of a young and dedicated academic staff with computer science background;
4. Institution has several collaboration agreements that support academic and professional exchange mobilities with national and international Higher Educational Institutions.
5. The library supports the study program with qualified staff, modern infrastructural facilities and physical and electronic book funds.
6. The higher education institution has an internal university management system used for administration, information and monitoring of academic, financial and administrative activities.
7. The institution applies national scholarship policies for students who need support, as well as for students with high academic results.


Weak points:

1. The partitions of the elements of the study program are not fully assigned in accordance with VKM.41 date 24.01.2018, amended, namely the Interdisciplinary component has a small deviation from the maximum 15% allowed is 15.6% [**Standard II .1/Criterion 1**]. The syllabis of the study program do not contain all the elements according to VKM.41 dated 24.01.2018, amended [**Standard II.3/Criterion 4 and Standard IV.1 Criterion 1**].
2. The institution does not have an approved procedure for planning the budget for the enrichment of literature in function of the fast-changing developments in the computer sceince discipline and the necessary literature fund in the library. [**Standard IV.3, Criterion 2**].
3. There are currently no active projects in this study program. The institution has not organised enough open lectures, trainings or seminars for the students of this study program. [**Standard III.4/Criterion 4 and 5 and Standard IV.5, Criterion 5**].



Recommendations:

1. The institution should partition the elements of the study program in accordance with VKM.41 date 24.01.2018, amended.
2. The institution should complete the syllabi of the study program according to VKM.41 dated 24.01.2018, amended; Identify lecturers of each courses according to the current legislation regarding their current qualification as well as complete the topics of seminars, exercises, laboratories and course assignments/projects;
3. The institution should define the procedure for enriching the literature of the study program, inside the HEI regulatory acts and notify the academic and administrative staff involved.
4. The institution should perform a periodic labour market and reflect the findings in the study program and syllabi.
5. The institution should involve and motivate the young academic staff in compliance with the current mechanisms for scientific research activities and projects.
6. The institution should increase the commitment to apply in national and international research projects, which apart from enhancing the teaching quality and learning performance in the study program, supports diversifying the financial incomes.
7. Prioritize on collaborations with diverse companies to support internships for the students of this study program.
8. The institution should publish online, institutional regulations, annual reports and the reports of questionnaires, so that they are more easily accessible by all interested parties and enrich the institution's official website with the missing sections.
9. The institution should engage in taking the necessary measures from the respective units for the continuous information of students on the importance of their representation in the decision-making inside the university.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X